KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

# RAPORTI VJETOR 2020

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

www.idp.al

Dita e Mbrojtjes së të Dhënave Personale
28 janar 2020

Udhëzim për mbrojtjen e të dhënave personale shëndetësore
2 mars 2020

Lock Down COVID-19
12 mars 2020

3 udhëzues për mbrojtjen e të dhënave personale në kuadër të masave kundër COVID-19
mars-maj 2020

Rizgjedhja e Komisionerit për një mandat 1-vjeçar si anëtar i Komitetit Ekzekutiv të GPA
22 korrik 2020

Publikimi i Raportit të Konferencës së 41-të Ndërkombëtare ICDPPC
7 gusht 2020

Dita e të Drejtës për Informim
28 shtator 2020

Fillimi i zbatimit të Projektit të Binjakëzimit
1 tetor 2020

Miratohet projektligji për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit në sektorin publik
12 tetor 2020

Miratimi në parim i Konventës 108+ të KiE
9 dhjetor 2020

Udhëzim për transmetimin e të dhënave të pasagjerit
10 dhjetor 2020

Udhëzim për institucionet që marrin të dhëna personale nga RKGjC
10 dhjetor 2020

Programi i rishikuar i Transparencës dhe Regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve
18 dhjetor 2020

Miratim në parim i Konventës 205 KiE
30 Dhjetor 2020

FJALOR SHPJEGUES

| | |
|---|---|
| BE | Bashkimi Evropian |
| Direktiva e Policisë | Direktiva (BE) 2016/680 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 27 prillit 2016 “Për mbrojtjen e personave fizikë në lidhje me përpunimin e të dhënave personale nga autoritetet kompetente me qëllim parandalimin, hetimin, zbulimin, ndjekjen penale të veprave penale apo ekzekutimin e dënimeve penale dhe për lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave |
| Direktiva 2019/1024 | Direktiva (BE) 2019/1024 “Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik”. |
| GDPR | Rregullore (BE) nr. 2016/679 “Për mbrojtjen e personave fizikë lidhur me përpunimin e të dhënave personale dhe për lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave” |
| GPA | Asambleja Globale e Privatësisë - Global Privacy Assembly |
| ICDPPC | Konferenca Ndërkombëtare e Komisionerëve të Mbrojtjes së të Dhënave dhe Privatësisë – International Conference of Data Protection and Privacy Commissioner’s |
| KiE | Këshilli i Evropës – Council of Europe |
| Konventa 108 | Konventa 108/1981 për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale e KiE |
| Konventa 108+ | Protokolli ndryshues nr. 223/2018 për amendimin e Konventës për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale e KiE |
| Ligji për mbrojtjen e të dhënave personale | Ligji nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar |

| | |
|---|---|
| Konventa 205 | Konventa 205/2009 mbi aksesin në dokumentet zyrtare e KiE |
| Ligji për gjendjen civile | Ligji nr. 10129/2009 "Për gjendjen civile", i ndryshuar |
| Ligji për policinë e shtetit | Ligji nr. 108/2014 "Për policinë e shtetit" |
| Ligji për të drejtën e informimit | Ligji nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" |
| Ligji për njoftimin dhe konsultimin publik | Ligji nr. 146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik" |
| Ligji për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive | Ligji nr. 15/2016 "Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive" |
| Ligji për masat shtesë të sigurisë publike | Ligji nr. 19/2016 "Për masat shtesë të sigurisë publike" |
| Ligji për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve | Ligji nr. 60/2016 "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve" |
| Ligji për kontrollin kufitar | Ligji nr. 71/2016 "Për kontrollin kufitar" |
| Marrëveshja Eurojust | Ligji nr. 113/2018 "Për ratifikimin e marrëveshjes për bashkëpunimin ndërmjet RSH dhe EUROJUST" |
| Ligji për masat shtrënguese ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë | Ligji nr. 72/2019 "Për masat shtrënguese ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë" |
| Pandemia COVID-19 | Pandemia e shkaktuar nga koronavirusi SARS-CoV-2 |
| Projekti i Binjakëzimit | Projekti i Binjakëzimit "Ndërtimi i institucioneve për harmonizimin me acquis të BE për të përmbushur kriteret ekonomike lidhur me mbrojtjen e të dhënave" |
| Program Transparence | Tërësia e informacionit dhe mënyrat e bërjes publike të tij nga autoriteti publik, sipas përcaktimeve të neneve 4 dhe 7 të ligjit për të drejtën e informimit |
| REKPDI | Regjistri elektronik i kërkesave dhe përgjigjeve për të drejtën e informimit |

| | |
|---|---|
| Rezoluta e Kuvendit | Rezolutë për vlerësimin e veprimtarisë së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2019, miratuar datë 21.05.2020 |
| SMSI | Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit |
| Urdhër nr. 14/2015 | Urdhrin nr. 14, datë 22.01.2015 "Për miratimin e Programit model të Transparencës" |
| Urdhër nr. 211/2018 | Urdhrin nr. 211, datë 10.09.2018 "Programi model i Transparencës për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore" |
| Udhëzim nr. 47/2018 | Udhëzim nr. 47, datë 14.09.2018 "Për përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga subjektet përpunuese të mëdha" |
| Udhëzim nr. 48/2018 | Udhëzim nr. 48, datë 14.09.2018 "Për certifikimin e sistemeve të menaxhimit të sigurisë së informacionit, të dhënave personale dhe mbrojtjes së tyre" |
| Udhëzim nr. 49/2020 | Udhëzim nr. 49, datë 02.03.2020 "Për mbrojtjen e të dhënave personale shëndetësore" |
| Udhëzim nr. 463/2020 | Udhëzim i ministrit të Brendshëm dhe Komisionerit nr. 463, datë 10.12.2020 "Për përcaktimin e institucioneve dhe organeve që marrin të dhëna personale nga Shërbimi i Gjendjes Civile, si dhe mënyrën, llojin dhe sasinë e informacionit që duhet të marrin" |
| Udhëzim nr. 464/2020 | Udhëzim i ministrit të Brendshëm dhe Komisionerit nr. 464, datë 10.12.2020 "Për transmetimin e të dhënave të pasagjerit te njësia e informacionit të pasagjerit". |
| VKM nr. 145/2018 | Vendim i Këshillit të Ministrave "Për krijimin e bazës të të dhënave shtetërore "Regjistri Elektronik i Kërkesave dhe Përgjigjeve për të drejtën e informimit"" |
| Zyra e Komisionerit | Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale |

## PËRMBAJTJA

**MESAZHI I KOMISIONERIT** ........ 7
**1.REFERENCAT LIGJORE KU MBËSHTETET VEPRIMTARIA E INSTITUCIONIT** ........ 8
**2. E DREJTA E INFORMIMIT** ........ 9
2.1 Monitorimi dhe mbikëqyrja e Programit të Transparencës së autoriteteve publike..... ........ 9
2.1.1 Transparenca në administratën shtetërore dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore........ 10
2.1.2 Rekomandime dhe Vendime për zbatimin e Programit të Transparencës ........ 11
2.1.3 Rishikimi i Programit të Transparencës dhe Regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve ........ 11
2.2 Regjistri elektronik i kërkesave dhe përgjigjeve për të drejtën e informimit ........ 12
2.3 Trajtimi i ankesave dhe hetimi administrativ ........ 12
2.4 Strategjitë Ndërsektoriale ........ 15
**3. MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE** ........ 16
3.1 Monitorimi dhe mbikëqyrja ........ 17
3.1.1 Trajtimi i ankesave ........ 17
3.1.2 Hetimet administrative ........ 17
3.1.3 Problematikat e konstatuara në konkluzion të hetimeve në kuadër të Rezolutës së Kuvendit ........ 19
3.1.4 Problematikat e konstatuara në konkluzion të hetimeve pranë kontrolluesve të tjerë... ........ 20
3.2 Vendimmarrja ........ 21
3.2.1 Rekomandime dhe Urdhra ........ 21
3.2.2 Rekomandime Unifikuese ........ 21
3.2.3 Sanksione administrative ........ 22
3.3 Njoftimi ........ 22
3.4 Transferimi ndërkombëtar ........ 23
**4. VEPRIMTARIA JURIDIKE, PROCEDURAT ADMINISTRATIVE DHE GJYQËSORE** ........ 24
4.1 Hartimi i akteve rregullatore ........ 24
4.1.1 Përafrimi i legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale me GDPR dhe Direktivën e Policisë ........ 24
4.1.2 Miratimi në parim i protokollit ndryshues të Konventës 108 të KiE ........ 24
4.1.3 Miratimi në parim i Konventës për aksesin në dokumentet zyrtare të KiE ........ 25
4.1.4 Miratimi i projektligjit mbi të dhënat e hapura dhe ri-përdorimin e informacionit të sektorit publik ........ 25
4.1.5 Projektligji për krijimin e Regjistrit të komunikimeve tregtare të pakërkuara 26
4.2 Udhëzimet ........ 26
4.3 Dhënie mendimi për projektakte ........ 27
4.4 Proceset gjyqësore ........ 27
**5. BASHKËPUNIMI, NDËRGJEGJËSIMI DHE PROMOVIMI I TË DREJTËS PËR INFORMIM DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE** ........ 29

5.1 Bashkëpunimi ndërkombëtar, ndërinstitucional dhe me shoqërinë civile .............. 29
5.1.1 Bashkëpunimi ndërkombëtar ..... 29
5.1.2 Marrëdhënia me EUROJUST ..... 29
5.1.3 Bashkëpunimi me shoqërinë civile ..... 30
5.2 Trajnime të Zyrës së Komisionerit ..... 31
5.3 Aktivitete të tjera ndërgjegjësuese ..... 31
**6. MENAXHIMI BUXHETOR** ..... 33
6.1 Struktura organizative ..... 33
6.2 Zhvillimi i burimeve njerëzore ..... 33
6.3 Të ardhurat dhe shpenzimet ..... 33
6.4 Të ardhurat nga sanksionet ..... 34
**7. RAPORT PROGRESI I KOMISIONIT EVROPIAN PËR SHQIPËRINË MBI ZYRËN E KOMISIONERIT** ..... 35
**8. PËRMBUSHJA E DETYRIMEVE NDËRKOMBËTARE DHE RAPORTIM** .. 37
**9. NIVELI I ZBATIMIT TË REZOLUTËS SË KUVENDIT 2020** ..... 38
**10. VIZIONI I INSTITUCIONIT** ..... 39

ANEKS 1 - STRUKTURA DHE ORGANIGRAMA ..... 40
ANEKS 2 - REKOMANDIMET E ZYRËS SË KOMISIONERIT PËR VITIN 2020 PËR KONTROLLUESIT PUBLIK DHE NIVELI I ZBATIMIT TË TYRE ..... 44
ANEKS 3 - MONITORIMI I FLETOREVE ZYRTARE ..... 63

# MESAZHI I KOMISIONERIT

Raporti Vjetor mbi veprimtarinë e Zyrës së Komisionerit për vitin 2020 u hartua në rrethana të ndryshme dhe specifike.

Viti që lamë pas, për të gjithë botën ishte tejet sfidues, pasi përhapja e virusit SARS-CoV-2 detyroi përshtatjen me një realitet krejtësisht tjetër. U ridimensionuan plotësisht marrëdhëniet ekonomiko-shoqërore dhe Shqipëria, si i gjithë globi, përshtati norma dhe masa për të luftuar pandeminë COVID-19.

Zhvillimi teknologjik i dekadës së fundit u përshpejtua në mënyrë marramendëse përgjatë vitit 2020. Shërbimet digjitale janë në qendër të vëmendjes, si për sa i përket mënyrës së ndryshuar të të punuarit dhe jetuarit, ashtu edhe asaj të komunikimit në rrafshin profesional dhe individual. Vendi ynë nuk bëri përjashtim nga kjo qasje, duke vënë në dispozicion burime njerëzore dhe financiare për këtë metodë të re veprimi.

Zyra e Komisionerit, në këtë situatë të paprecedentë, përshtati burimet e saj për të adresuar sa dhe si duhet efektet e pandemisë në monitorimin dhe mbikëqyrjen e të dy sferave të veprimtarisë. Fokusi kryesor ishte marrja e masave për të garantuar vazhdimësinë dhe mirëfunksionimin e aktivitetit institucional, njëkohësisht, duke mos cenuar përmbushjen rigoroze të detyrimeve ligjore, si në fushën e të drejtës për informim ashtu edhe në atë të mbrojtjes së të dhënave personale.

Statistikat e vitit 2020, janë treguesi i kësaj qasje të drejtë të autoritetit në raport me ushtrimin praktik të të drejtave të qytetarëve, 1023 ankesa u administruan për të dy fushat e veprimtarisë.

Projekti i Binjakëzimit *“Ndërtimi i institucioneve për harmonizimin me acquis të BE për të përmbushur kriteret ekonomike lidhur me mbrojtjen e të dhënave”*, nisi zbatimin në 1 tetor 2020. Synimi i Zyrës së Komisionerit dhe partnerëve është që brenda vitit në vijim Shqipëria të ketë kuadrin e ri rregullator të mbrojtjes së të dhënave të përafruar me GDPR dhe Direktivën e Policisë. Paralelisht, u miratua në parim nga Këshilli i Ministrave edhe akti shumë të rëndësishëm i Këshillit të Evropës, Konventa 108+.

Nga ana tjetër, përpjekjet nuk janë ndalur vetëm në arritjen e standardeve ndërkombëtare në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, por edhe në angazhimin për plotësimin e kuadrit ligjor për të drejtën e informimit, si miratimi në parim i Konventës së Këshillit të Evropës 205/2009 si dhe transpozimi i Direktivës 2019/1024 “Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik”.

Këto hapa, përveçse pjesë e procesit të integrimit evropian të vendit, ju garantojnë qytetarëve shqiptarë standarde akoma edhe më moderne në ushtrimin praktik të të drejtave të tyre kushtetuese.

Së fundi, por jo nga rëndësia, Zyra e Komisionerit ka dhënë kontribute konkrete në kuadër të organizatave dhe forumeve ndërkombëtare ku ajo është anëtare. Zgjerimi i rolit të saj është vlerësim për një autoritet me resurse të kufizuara, por me iniciativë dhe me dëshirë për t’u zhvilluar e përmirësuar gjithnjë.

# 1. REFERENCAT LIGJORE KU MBËSHTETET VEPRIMTARIA E INSTITUCIONIT

Veprimtaria e institucionit mbështetet në zbatimin e detyrimeve që burojnë nga akte ndërkombëtare ku Shqipëria është palë, kuadri i brendshëm rregullator për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale, si dhe në rekomandimet e Rezolutës së Kuvendit. Gjithashtu, Zyrës së Komisionerit i burojnë detyrime edhe nga ligje të tjera:

- ✓ Ligji për njoftimin dhe konsultimin publik
- ✓ Ligji për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve;
- ✓ Ligji për masat shtesë të sigurisë publike;
- ✓ Ligji për kontrollin kufitar;
- ✓ Ligji për ratifikimin e marrëveshjes për bashkëpunimin ndërmjet RSH dhe EUROJUST;
- ✓ Ligji për masat shtrënguese ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë;
- ✓ Ligji për gjendjen civile;
- ✓ Ligji për policinë e shtetit;
- ✓ Ligji për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive.

Zyra e Komisionerit bashkëpunoi me Ministrinë e Brendshme për miratimin e 2 akteve nënligjore, në zbatim të Ligjit për kontrollin kufitar dhe atij për gjendjen civile.

Institucioni i ka kushtuar rëndësi monitorimit të zbatimit të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale në kuadër të detyrimeve që burojnë nga Ligji për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve. Gjatë këtij viti nuk u referuan raste/çështje pranë Zyrës së Komisionerit, megjithatë, gjatë kryerjes së inspektimeve *ex officio* në kontrollues të ndryshëm publik dhe privat, është mbikëqyrur dhe respektimi i legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale nga subjektet e këtij ligji.

Në përmbushje të detyrës për shqyrtimin e ankesave në lidhje me procedurat e parashikuara në Ligjin për njoftimin dhe konsultimin publik, për vitin 2020, nuk është administruar asnjë ankesë me objekt shkeljen e dispozitave të tij.

Në lidhje me përmbushjen e detyrimeve të Marrëveshjes me EUROJUST, një përshkrim më të detajuar gjendet në pikën 5.1.2 të këtij Raporti.

Përsa i përket detyrimeve të parashikuara në Ligjin për masat shtrënguese ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë, Zyra e Komisionerit, ka përmbushur detyrimet e përcaktuara në dispozitat e tij.

## 2. E DREJTA E INFORMIMIT

Pandemia COVID-19 dha ndikimin e saj edhe në përmbushjen e të drejtës së qytetarëve për qasje në informacionin me karakter publik, parashikuar nga ligji për të drejtën e informimit. Autoritetet publike u përshtatën me situatën e krijuar, në përputhje me masat e vendosura nga institucionet shëndetësore, duke përmbushur, gjithsesi, detyrimet e parashikuara nga ky ligj për trajtimin e kërkesave për informacion.

Në ndryshim nga praktika ndërkombëtare, ku një numër shumë i lartë shtetesh e kufizuan zbatimin e kësaj të drejte, duke e pezulluar me të paktën 30-60 ditë, në vendin tonë nuk pati asnjë vendimmarrje të kësaj natyre. Edhe Zyra e Komisionerit, pavarësisht këtyre vështirësive objektive, vijoi rregullisht aktivitetin në trajtimin e ankesave.

Njëkohësisht, në kuadër të ndëgjegjësimit institucioni ndërmori një sërë veprimesh dhe aktivitetesh, duke u fokusuar në:

*i) monitorimin e detyrimit për zbatimin dhe përditësimin e programit të transparencës dhe regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve;*

*ii) instalimin e REKPDI në më shumë autoritete publike;*

*iii) monitorimin e zbatimit të detyrimit për caktimin e koordinatorit për të drejtën e informimit nga autoritetet publike dhe trajnimin e vazhdueshëm të tyre;*

*iv) dhënien e rekomandimeve për autoritetet publike, në lidhje me programin e trasparencës dhe regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve;*

*v) shqyrtimin e ankesave në përputhje me afatet e parashikuara në Ligjin për të drejtën e informimit, duke përfshirë zhvillimin e inspektimeve apo seancave dëgjimore;*

*vi) përmbushjen e objektivave të parashikuara në strategjitë ndërsektoriale në të cilat Zyra e Komisionerit është pjesë;*

*vii) zhvillimin e aktiviteteve ndërgjegjësuese për të drejtën e informimit, në kushtet e pandemisë.*

### 2.1 Monitorimi dhe mbikëqyrja e Programit të Transparencës së autoriteteve publike

Ligji për të drejtën e informimit garanton transparencën proaktive dhe nxit integritetin, llogaridhënien dhe përgjegjshmërinë e autoriteteve publike. Një prej instrumentave kryesorë të tij është Programi i Transparencës. Megjithatë, konstatohet se vijon të ketë mospërmbushje nga ana e disa autoriteteve publike të këtij detyrimi. Shkak janë faktorë të tillë, si mungesa e faqeve zyrtare të internetit për publikimin e këtij instrumenti apo mungesa e kapaciteteve njerëzore për zbatimin dhe përditësimin e tij.




### 2.1.1 Transparenca në administratën shtetërore dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore

Me qëllim matjen e transparencës proaktive, Zyra e Komisionerit gjatë vitit 2020 zhvilloi dy monitorime në kategori të ndryshme autoritetesh publike. Gjetjet u trajtuan në seanca dëgjimore me pjesëmarrjen e titullarëve apo drejtuesve të autoriteteve publike të monitoruara dhe koordinatorët e të drejtës për informim.

a) *Raporti i Monitorimit dhe Indeksi i Transparencës Proaktive të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore*

Monitorimi i parë, ka të bëjë me monitorimin e transparencës proaktive të 61 njësive të vetëqeverisjes vendore dhe hartimin e Raportit respektiv. Metodologjia e matjes u bazua në 4 tregues kryesorë: (a) publikimi i programit model të transparencës, (b) përditësimi i regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve për vitin 2020, (c) publikimi i të dhënave të koordinatorëve dhe (ç) instalimi i REKPDI.

b) *Raporti i Monitorimit dhe Indeksi i Transparencës Proaktive të Institucioneve Qendrore dhe të Varësisë.*

Monitorimi i dytë ka të bëjë me matjen e transparencës proaktive të 36 institucioneve qendrore (kryeministria dhe ministritë) dhe atyre të varësisë, si dhe hartimin e Raportit përkatës. Metodologjia e përdorur i referohet 5 treguesve kryesorë të cilët janë: (a) publikimi i programit model të transparencës, (b) përditësimi i regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve për vitin 2020, (c) publikimi i të dhënave të koordinatorit; (ç) publikimi i të dhënave për buxhetin dhe planin e shpenzimeve për vitin 2020 dhe (d) instalimi i REKPDI.

Të dy këto Raporte monitorimi gjenden të publikuar në faqen zyrtare të internetit të Zyrës së Komisionerit në lidhjen https://www.idp.al/?s=indeksi+i+transparences.

### 2.1.2 Rekomandime dhe Vendime për zbatimin e Programit të Transparencës

Nga monitorimet e kryera, Komisioneri doli me 22 Rekomandime për ato autoritete publike të cilat kanë rezultuar se kanë pasur mangësi në publikimin e informacionit sipas Urdhrit nr. 14, datë 22.01.2015 *"Për miratimin e Programit model të Transparencës*" dhe Urdhrit nr. 211, datë 10.09.2018 "*Programi model i Transparencës për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore*".

Bazuar në të dhënat e Raportit të Monitorimit të Transparencës Proaktive të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore, në fund të vitit 2020, Zyra e Komisionerit, zhvilloi 11 hetime administrative me objekt monitorimin e vënies në zbatim të programit të transparencës. Në përfundim, Komisioneri doli me 3 Vendime me sanksion administrativ për personat përgjegjës.

### 2.1.3 Rishikimi i Programit të Transparencës dhe Regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve

Rishikimi i Programit të Transparencës dhe Regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve nuk ishte vetëm një detyrë e parashikuar në ligjin për të drejtën e informimit, por edhe një kërkesë nga qytetarë, shoqëria civile dhe vetë autoritetet publike. Zyra e Komisionerit hartoi modelin e ri të Programit të Transparencës dhe të Regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve. Në këto dokumente janë specifikuar çdo lloj informacioni e dokumentacioni që duhet të publikohet për secilën kategori dhe gjithashtu, krijuan modele miqësore për konsultimin e tyre në internet.

Programi i ri i Transparencës u miratua me Urdhrin e Komisionerit nr. 187, datë 18.12.2020 "*Për Miratimin e Programit të Transparencës të Rishikuar*".




Ndërsa, me Urdhrin nr. 188, datë 18.12.2020 u miratua modeli i rishikuar i Regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve. Risia e këtij formati qëndron në detyrimin e autoriteteve publike për të plotësuar të dhëna të detajuara lidhur me mënyrën e trajtimit të kërkesave për informacion.

**REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE**

| Nr. Rendor [1] | Data e kërkesës[2] | Objekti i kërkesës[3] | Data e përgjigjes[4] | Përgjigje[5] | Mënyra e përfundimit të kërkesës[6] | Tarifa[7] |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |

Programi i rishikuar i Transparencës dhe i Regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve duhet të zbatohet nga të gjitha autoritetet publike, me përjashtim të njësive të vetëqeverisjes vendore, jo më vonë se data 31 mars 2021.

## 2.2 Regjistri elektronik i kërkesave dhe përgjigjeve për të drejtën e informimit

Me VKM nr. 145/2018 u miratua krijimi i një Regjistri qendror të kërkesave dhe përgjigjeve për të drejtën e informimit. E ndodhur në kushtet e mungesës së fondeve për shtrirjen më tej të instalimit të REKPDI, Zyra e Komisionerit, gjatë vitit 2020 kërkoi nga njësitë e vetëqeverisjes vendore marrjen e masave për instalimin e tij. Regjistrin e instaluan 28 autoritete të reja publike, duke e çuar në 59 numrin total të institucioneve që e kanë funksional atë.

**AUTORITETET PUBLIKE QË KANË INSTALUAR REKPDI**




Numri i kërkesave për informacion publik të trajtuara nëpërmjet këtij Regjistri, nga 59 autoritete publike, është 430. Për të njëjtën periudhë, numri i ankesave të administruara nga Zyra e Komisionerit, nëpërmjet këtij regjistri, ishte 112. Me instalimin e REKPDI pranë autoriteteve publike, njëkohësisht janë trajnuar për përdorimin e tij koordinatorët e të drejtës për informim.

## 2.3 Trajtimi i ankesave dhe hetimi administrativ

Gjatë vitit 2020 u administruan 715 ankesa nga qytetarë, përfaqësues të shoqërisë civile dhe gazetarë investigativë, si dhe u vijua shqyrtimi i 28 ankesave të mbartura nga viti 2019.

## ANKESAT 2017 – 2020




Nga numri total i ankesave të shqyrtuara, për 472 prej tyre është vënë në dispozicion të ankuesit informacioni/dokumentacioni i kërkuar gjatë procesit të hetimit administrativ. Nga totali i ankesave të administruara, 24 rezultuan jashtë afatit, 13 ishin të paplota, 131 jashtë objektit, 23 u trajtuan sipas kufizimeve të nenit 17 të Ligjit për të drejtën e informimit, 1 ankesë është pezulluar dhe 44 u mbartën për shqyrtim në vitin 2021.

## ANKESA 2020




Me synim verifikimin e ankesave të depozituara, si dhe ndjekjen të procedurave të mëtejshme te shqyrtimit administrativ janë zhvilluar 19 seanca dëgjimore dhe 50 inspektime pranë autoriteteve publike.




Për 35 ankesa Komisioneri është shprehur me Vendim, prej të cilëve 30 vendime urdhërimi për dhënie informacioni, 4 vendime rrëzimi dhe 1 vendim mospranimi.

Referuar të dhënave të mbajtura nga Zyra e Komisionerit, për aq sa mund të indentifikohen, ankesat e paraqitura jane grupuar në tre kategori: nga qytetarë, nga organizata të shoqërisë civile dhe nga gazetarë investigativë.




Situata me pandeminë COVID-19, vetvetiu, adresoi pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe institucioneve të saj të varësisë numër të lartë kërkesash për informacion, kryesisht nga organizata të shoqërisë civile dhe gazetarë.

Gjatë shqyrtimit administrativ të ankesave për vitin 2020, Zyra e Komisionerit ka konstatuar këto problematika kryesore:

i. *vështirësi në trajtimin e kërkesave për informacion në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi, kushtëzuar nga situatë e pandemisë COVID-19*;

ii. *ndryshim i koordinatorit për të drejtën e informimit, caktim në nivel ekzekutiv apo të ulët drejtues, si dhe akses i kufizuar në strukturat e tjera të autoritetit publik;*

iii. *delegim i kërkesave për informacion në struktura të tjera të autoritetit, duke anashkaluar koordinatorin dhe procedurën e përcaktuar në ligj;*

iv. *paqartësi nga ana e autoriteteve publike lidhur me konceptin e konfidencialitetit në kontratat publike, i trajtuar jo në përputhje me parashikimet e nenit 17 të Ligjit për të drejtën e informimit;*

v. *tendencë e kërkuesve për të përdorur dispozitat e Ligjit përtej objektit dhe qëllimit të tij, si:*

a) *krijimi dhe/ose përpunimi i statistikave të reja për interes të kërkuesit;*

b) *paqartësi për marrjen e shërbimin për shkak të detyrës funksionale të autoritetit publik me përdorimin e dispozitave të Ligjit për të drejtën e informimit;*

c) *përdorim i të drejtës për informim në realizimin e interesave personale pasurore dhe jopasurore të kërkuesit.*

## 2.4 Strategjitë Ndërsektoriale

Institucioni është pjesë dhe raporton në mënyrë periodike mbi progresin e objektivave dhe aktiviteteve të parashikuara në këto strategji:

✓ *Strategjia Ndërsektoriale për Reformën në Administratën Publike 2015-2022 dhe Plani i ri i aktiviteteve 2018-2022*

Zyra e Komisionerit është institucioni përgjegjës për realizimin e Objektivit 11 *"Rritja e kontrollit mbi veprimtarinë e administratës publike për garantimin e të drejtave të qytetarëve dhe aksesi në informacion".* Me qëllim përmbushjen e këtij objektivi gjatë periudhës raportuese u realizuan të tetë nënmasat e parashikuara në Planin vjetor të Veprimit dhe vijon puna për realizimin e nënmasës së nëntë në vitin 2021.

✓ *Strategjia Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit dhe Plani i Veprimit 2020-2023*

Zyra e Komisionerit është institucioni përgjegjës për realizimin e objektivit A.1 *"Rritja e transparencës në veprimtarinë shtetërore dhe përmirësimi i aksesit të qytetarëve në informacion".* Me qëllim përmbushjen e këtij objektivi u realizuar të tre masat e parashikuara në Planin vjetor të Veprimit për të cilat është institucioni përgjegjës.

✓ *Strategjia për Edukimin Ligjor të Publikut 2019-2023 dhe Plani i Veprimit 2019–2023*

Strategjia për Edukimin Ligjor të Publikut 2019-2023 është dokumenti i parë strategjik i miratuar në Shqipëri me fokus të veçantë edukimin ligjor të qytetarëve. Strategjia shoqërohet edhe nga Plani i Veprimit, në të cilin Zyra e Komisionerit është përgjegjëse për zbatimin e 5 aktiviteteve, në funksion të përmbushjes së Objektivit të katërt *"Ndërgjegjësimi i publikut për rëndësinë e njohjes së ligjit, të drejtave dhe detyrimeve të tyre, bazuar në nevojat specifike dhe nxitjen e aktivizimit qytetar për forcimin e shtetit të së drejtës".* Gjatë vitit 2020, u realizuan plotësisht aktivitetet e parashikuara në Planin e Veprimit.

✓ *Kontrata Sektoriale e Mbështetjes Buxhetore për Reformën në Administratën Publike 2015-2020*

Nga vetëdeklarimi i 128 autoriteteve publike, i dhënë në funksion të Kontratës Sektoriale të Mbështetjes Buxhetore për Reformën në Administratën Publike, rezulton se për vitin 2020 janë trajtuar 21616 kërkesa për informacion, nga të cilat 219 nuk kanë marrë përgjigje. Përqindja e kërkesave për informacion të refuzuar përbën 1% të numrit total të kërkesave.

## 3. MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE

Gjatë vitit 2020, krahas angazhimeve monitoruese dhe mbikëqyrëse të veprimtarisë së kontrolluesve/përpunuesve në lidhje me përmbushjen e detyrimeve të Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, Zyra e Komisionerit i ka kushtuar një vëmendje të veçantë sektorit të shëndetësisë. Ky fokus është diktuar, natyrshëm, nga pandemia COVID-19, ngjarje e cila vijon të kufizojë rrjedhën normale të jetës së qytetarëve dhe me të, edhe ekspozimin e tyre ndaj cenimeve eventuale të së drejtës për mbrojtjen e të dhënave personale.
Angazhimet e Zyrës së Komisionerit në lidhje me këtë sektor janë zhvilluar në disa plane:

- Së pari, në dhënien e asistencës dhe mbështetjen e organeve ligjzbatuese të pozicionuara në vijën e parë të luftës kundër COVID-19. Ky aspekt ka rezultuar, veçanërisht, i rëndësishëm gjatë periudhës së gjendjes së emergjencës të shpallur në gjysmën e parë të vitit 2020.
- Së dyti, në rrafshin rregullator, reflektuar në miratimin e Udhëzimit nr. 49 të Komisionerit, si dhe në përgatitjen dhe publikimin e 3 udhëzuesve dedikuar, posaçërisht, përpunimit të të dhënave personale, nga kontrolluesit publik e privat, gjatë periudhës së pandemisë:
  (i) Udhëzuesi për mbrojtjen e të dhënave personale në kuadër të masave kundër COVID-19;
  (ii) Udhëzuesi për përpunimin e të dhënave personale në sektorë specifikë në kuadër të masave kundër COVID-19;
  (iii) Udhëzuesi për përpunimin e të dhënave personale në kuadër të Protokolleve të Masave Higjeno-Sanitare COVID-19.

Qëllimi kryesor i këtyre instrumenteve ka qenë orientimi korrekt i kontrolluesve/përpunuesve në lidhje me përpunimin e drejtë dhe të ligjshëm të të dhënave personale në situatën e shkaktuar nga pandemia.

- Së treti, në kuadër të veprimtarisë së saj mbikëqyrëse në terren, nëpërmjet inspektimeve të kryera pranë institucione publike dhe subjekteve private të kujdesit shëndetësor. Ky angazhim është zhvilluar edhe në kuadër të detyrave të lëna nga Rezoluta e Kuvendit, në zbatim të të cilës Zyra e Komisionerit ka depozituar, tashmë, një raport të posaçëm.

Një vend të rëndësishëm në veprimtarinë e institucionit, ka zënë mbikëqyrja e kontrolluesve publik e privat të cilët operojnë në sektorin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit. Fokus ka qenë mbikëqyrja e respektimit të masave teknike dhe organizative gjatë ushtrimit të veprimtarive të tyre përpunuese. Konkretisht, i është kushtuar vëmendje verifikimit të masave të marra në lidhje me sistemet e menaxhimit të sigurisë së informacionit për mbrojtjen e të dhënave personale, bazuar në dispozitat e Udhëzimeve nr. 47 dhe nr. 48 të Komisionerit.

Zyra e Komisionerit ka adresuar detyrat e lëna nga Rezoluta e Kuvendit për mbikëqyrjen e kontrolluesve publik që përdorin platforma *online* dhe gjetjet janë paraqitur në Raportin e posaçëm të depozituar në Kuvend.

### 3.1 Monitorimi dhe mbikëqyrja

#### 3.1.1 Trajtimi i ankesave

Gjatë vitit 2020, pranë Zyrës së Komisionerit u administruan 308 ankesa, një shifër pak më e lartë se një vit më parë. Në trajtimin e tyre, synimi kryesor ishte mbrojtja e të drejtave të subjektit të të dhënave-qytetarit, por edhe ndërgjegjësimi i kontrolluesve/përpunuesve për domosdoshmërinë e përmbushjes së detyrimeve që parashikon ligji.

Në 60% të ankesave të trajtuara, objekt i tyre është cenimi i të drejtës së subjektit të të dhënave personale për akses dhe ato në lidhje me marketingun e drejtpërdrejtë. Ndërsa, është konstatuar se një numër në rritje ankesash kanë lidhje me përpunimin e të dhënave personale nëpërmjet platformave *online*, sidomos, gjatë periudhës së pandemisë, e në vijim.

**ANKESA 2017 – 2020**




#### 3.1.2 Hetimet administrative

Gjatë vitit 2020 u realizuan 60 procese hetimi administrativ. Nga këto, 21 janë iniciuar mbi bazë të ankesave dhe 39 me nismën e institucionit, ndër të tjera, edhe të Rezolutës së Kuvendit. 15 hetime administrative janë realizuar në kontrollues publik dhe 45 në kontrollues privat.

**HETIMET ADMINISTRATIVE 2020**



## SEKTORËT E HETIMIT ADMINISTRATIV

- SEKTORI I KUJDESIT SHËNDETËSOR
- SEKTORI I TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT DHE KOMUNIKIMIT
- SEKTORI I TELEKOMUNIKACIONIT
- SEKTORI CALL CENTER
- ZYRA LIGJORE, TË CILAT USHTROJNË VEPRIMTARI NË FUSHËN E ZGJERIMIT TË PUNËVE TË TË TRETËVE

Situata e krijuar nga pandemia kushtëzoi dhe kufizoi veprimtaritë inspektuese në terren në krahasim me vitin 2019. Megjithatë, Zyra e Komisionerit përfundoi procesin e adresimit dhe zbatimit të rekomandimeve sipas Rezolutës së Kuvendit, veçanërisht, me monitorimin dhe mbikëqyrjen e kontrolluesve me fokus platformat *online*, sektorin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit ose sektorë që përpunojnë të dhëna sensitive.

Konkretisht, me Urdhrin nr. 91/2020 të Komisionerit u ngritën dy grupe pune për koordinimin dhe ekzekutimin e detyrave sipas rekomandimit në fjalë. Në vijim, iu drejtua kërkesë për informacion 82 institucioneve publike në kuadër të evidentimit dhe analizimit të bazave të të dhënave dhe platformave online në administrim e tyre. 68 institucione kthyen përgjigje.

Pas ezaurimit të procesit të verifikimit paraprak, u zhvilluan hetime administrative pranë 9 institucioneve publike, duke i dhënë prioritet sipas fushës së tyre të përgjegjësisë dhe operacioneve më të rëndësishme të përpunimit të të dhënave personale, bazuar në rëndësinë dhe frekuencën e shërbimit publik që ato ofrojnë. Inspektimet u fokusuan në zbatimin e legjislacionit në fuqi në lidhje me masat e sigurisë për të dhënat personale, me qëllim garantimin e sigurisë së tyre me krijimin e Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit (SMSI).

Paralelisht, u zhvilluan inspektime administrative pranë 3 institucioneve shëndetësore publike dhe 3 subjekteve shëndetësore private, të cilat, ndër të tjera, janë të angazhuar në procesin e survejancës dhe hetimit epidemiologjik të COVID-19. Inspektimet u fokusuan në zbatimin e detyrimeve të legjislacionit në fuqi dhe 3 udhëzuesve për përpunimin e të dhënave personale (sensitive) për menaxhimin e situatës së krijuar nga pandemia.

### 3.1.3 Problematikat e konstatuara në konkluzion të hetimeve në kuadër të Rezolutës së Kuvendit

Disa nga problematikat e konstatuara gjatë hetimeve administrative të realizuara pranë kontrolluesve me fokus platformat *online* dhe teknologjinë e informacionit dhe komunikimit janë:

(i) në pjesën më të madhe të kontrolluesve publik, aspekti rregullator i mbrojtjes së të dhënave personale në proceset përpunuese përmes TIK është i veçuar nga rregullat për proceset e tjera përpunuese. Institucionet e administratës shtetërore që ofrojnë shërbime në këtë sektor duhet të parashikojnë në mënyrë konkrete të gjitha proceset përpunuese me akte të mirëfillta rregullatore për garantimin e të drejtave të subjektit të të dhënave.

(ii) Mungesë e njohurive ligjore dhe teknike dhe ndërgjegjësimi mbi detyrimet që parashikon në tërësi legjislacioni për mbrojtjen e të dhënave personale.

(iii) Mangësi në adresimin e elementeve, detyrimeve dhe garancive ligjore në lidhje me marrëdhëniet kontraktore që institucionet publike (në cilësinë e kontrolluesit) lidhin me palë të treta (në cilësinë e përpunuesit) për delegimin e shërbimeve të ndryshme, ku në thelb të tyre ka edhe përpunim të të dhënave personale.

(iv) Janë konstatuar akte të brendshme rregullatore të cilat disponojnë vetëm rregullime të përgjithshme për menaxhimin e të dhënave personale dhe ruajtjen e konfidencialitetit të subjekteve të të dhënave. Këto akte, në pjesën më të madhe rezultojnë të padetajuara në lidhje me masat tekniko-organizative të përshtatshme dhe të zbatueshme për garantimin e mbrojtjes së të dhënave personale dhe sensitive, kriteret e ligjshmërisë së përpunimit të të dhënave të pacientëve, masat për garantimin e gjurmueshmërisë dhe kontrollit të veprimeve të personave/personelit që ka pasur dhe/ose ka akses në këto të dhëna, si dhe për mënyrën e shkatërrimit të tyre, kur të jetë përmbushur qëllimi i përpunimit të tyre.

(v) Mungesë angazhimi në drejtim të trajnimit të punonjësve që kanë akses në të dhënat personale dhe mbikëqyrin proceset përpunuese dhe në drejtim të konsolidimit të praktikave dhe legjislacionit specifik që rregullon veprimtarinë e tyre. Gjithashtu, mbetet e një rëndësie themelore nevoja për të modernizuar infrastrukturën dhe aktet rregullatore që lidhen me sistemet dhe bazat e të dhënave.

(vi) Pjesa më e madhe e kontrolluesve nuk kanë venë në zbatim mekanizmat e nevojshëm për kontrollet dhe monitorimin e aktiviteteve të TIK, me qëllim zhvillimin, operimin, menaxhimin dhe mirëmbajtjen e tyre. Rezultatet e kontrollit kanë treguar se ka vështirësi në menaxhimin e burimeve të teknologjisë së informacionit.

(vii) Mungesë e një strategjie ose plani për zbatimin e SMSI për mbrojtjen e të dhënave personale, që përfshin të gjithë komponentët e një sistemi të kompletuar për menaxhimin e sigurinë së informacionit, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Përmirësimi i vazhdueshëm është një aspekt kyç i SMSI, në përpjekjen për të realizuar dhe ruajtur konfidencialitetin, integritetin, disponueshmërinë dhe besueshmërinë e sigurisë së informacionit dhe duhet të jetë pjesë e integruar e objektivave të kontrolluesve publik.

Nga ana tjetër, në sektorin e kujdesit shëndetësor rezultojnë, ndër të tjera, problematikat si vijon:

(i) Mungojnë rregulla të qarta për masat tekniko-organizative në procesin e përpunimit të të dhënave personale.
(ii) Mungon çdo element i infrastrukturës së nevojshme për ngritjen, mirëmbajtjen dhe administrimin e SMSI për mbrojtjen e të dhënave personale.
(iii) Mungon informimi i subjekteve të të dhënave, në lidhje me kohëzgjatjen e përpunimit të të dhënave të tyre, të drejtën për të kërkuar, sipas rastit, akses, korrigjim, fshirje, etj., si dhe në lidhje të çdo elementi tjetër informimi të detyrueshëm për kontrolluesit.
(iv) Kontrolluesit nuk disponojnë rregullime konkrete për menaxhimin e të dhënave personale dhe ruajtjen e konfidencialitetit të subjektit të të dhënave në përdorimin e faqes zyrtare të internetit, duke mos informuar për procesin dhe të drejtat e subjektit të të dhënave dhe detyrimet e tyre në kuadër të mbrojtjes së privatësisë.
(v) Kontrolluesit nuk respektojnë detyrimin për të njoftuar dhe përditësuar të dhënat personale, sa herë që përpunohen kategori apo sasi të ndryshme, me qëllim informimin e subjektit të të dhënave për çdo përpunim të ri të tyre.

Për të dy këto kategori inspektimesh, Zyra e Komisionerit i paraqiti Kuvendit një Raport të posaçëm më datë 08.02.2021.

### 3.1.4 Problematikat e konstatuara në konkluzion të hetimeve pranë kontrolluesve të tjerë

Në konkluzion të hetimeve administrative të realizuara pranë kontrolluesve të tjerë vërehen problematika thuajse të ngjashme, në lidhje me detyrimet e përgjithshme të këtyre subjekteve në kuadër të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale dhe sidomos, në drejtim të masave tekniko-organizative që synojnë garantimin e sigurisë së të dhënave personale. Ndër problematikat e konstatuara vërejmë:

(i) mos depozitim njoftimi pranë Zyrës së Komisionerit, në lidhje me gjendjen fillestare të përpunimit të të dhënave dhe ndryshimet e mëpasshme të saj;
(ii) përpunim në kundërshtim me parimet dhe kriteret ligjore të përpunimit të të dhënave;
(iii) mosrespektim i të drejtave të subjekteve të të dhënave;
(iv) mosrespektim i detyrimit për njoftim nga kontrolluesit/përpunuesit;
(v) mosrespektim dhe mosadresim i detyrimeve që rrjedhin në kuadër të delegimit të proceseve përpunuese;
(vi) në pjesën më të madhe të kontrolluesve konstatohen masa tekniko-organizative të pjesshme, deri në mungesë të plotë, duke passjellë pasiguri në drejtim të garantimit të sigurisë së të dhënave dhe ruajtjes së konfidencialitetit të tyre;

Veçanërisht, për t'u theksuar është fakti se pjesa dërrmuese e kontrolluesve nuk disponojnë SMSI për mbrojtjen e të dhënave personale, si dhe nuk respektojnë detyrimet e parashikuara në Udhëzimin nr. 47 të Komisionerit.

Pas përfundimit të hetimeve administrative janë zhvilluar 44 seanca dëgjimore.

## 3.2 Vendimmarrja

### 3.2.1 Rekomandime dhe Urdhra

Nëpërmjet këtyre akteve të Komisionerit është synuar të ndërgjegjësohet çdo kontrollues/përpunues i të dhënave për të kryer përpunime në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme, por pa cenuar privatësinë e individit.

Gjatë vitit 2020 Komisionerit është shprehur me:

- 20 Rekomandime:
  - 2 për 58 kontrollues në sferën publike dhe
  - 18 për kontrollues në sferën private.

- 3 Urdhra për kontrollues në sferën private në lidhje me:
  - *ndërprerjen e menjëhershme të përpunimit të të dhënave personale nëpërmjet sistemit CCTV;*
  - *shkatërrimin e menjëhershëm të të dhënave të grumbulluara në mënyrë të paligjshme;*
  - *ndërprerjen e menjëhershme të përpunimit të të dhënave personale te palë të treta.*

### 3.2.2 Rekomandime Unifikuese

Nisur nga përvoja pozitive e Rekomandimeve Unifikuese të Komisionerit, edhe këtë vit, është vijuar me dhënien e Rekomandimeve të kësaj natyre.

Rekomandimet e nxjerra për Institucionet e Administratës Shtetërore kanë konsistuar në:

a. caktimin e personit të kontaktit për mbrojtjen e të dhënave personale;

b. publikimin e "*politikave të privatësisë*" në faqet e tyre zyrtare të internetit.

#### Forcimi i rolit të personit të kontaktit

Në lidhje me *aspektin ligjor*, Zyra e Komisionerit synon të rregullojë rolin dhe detyrat e personit të kontaktit me dispozita në ligjin e ri për mbrojtjen e të dhënave personale, i cili do të jetë produkti kryesor i Projektit të Binjakëzimit në përafrimin e GDPR dhe Direktivës së Policisë.

Ky përmirësim i rolit të personit të kontaktit, nga rregullimi në aktet nënligjore në dispozita në ligjin e ri, i jep këtij funksioni tiparet e një organi/organizmi autonom brenda strukturës organizative të çdo kontrolluesi. Këto atribute e ngarkojnë personin e kontaktit me përgjegjësi konkrete për evidentimin e shkeljeve eventuale të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale nga kontrolluesit përkatës, si dhe paralajmërimin e këtyre të fundit për të marrë masat e duhura.

Ushtrimi i funksioneve të personit të kontaktit do të mund të realizohet në të dy format e angazhimit të burimeve njerëzore që përdoren sot, konkretisht, në cilësinë e punëmarrësit

ose të ofruesit të shërbimit. Në çdo rast, dispozitat e ligjit të ri do të parashikojnë kritere të konsoliduara autonomie për këtë pozicion.

Në *aspektin praktik*, Zyra e Komisionerit, në kuadër të inspektimeve të ndërmarra, ka synuar të nxjerrë në pah rëndësinë e rolit të personit të kontaktit. Ekzistenca dhe funksionaliteti i personit të kontaktit është një nga çështjet e para që verifikohen gjatë procesit të hetimit administrativ.

Publikimi i politikave të privatësisë

Zyra e Komisionerit, gjatë ushtrimit të hetimeve administrative në kontrolluesit e sipër cituar, ka konstatuar se një pjesë e tyre nuk kanë vendosur "*politikat e privatësisë*" në faqet/portalet zyrtare të tyre dhe për këtë qëllim, Komisioneri doli me Rekomandim Unifikues.

Çdo kontrollues ka detyrim që të publikojë "*politikat e privatësisë*", pasi kontakti paraprak i çdo subjekti të dhënash realizohet nëpërmjet faqes/portalit zyrtar, pavarësisht faktit nëse përpunimi bëhet në mënyrë elektronike apo manuale dhe nëse mbledh apo jo të dhëna personale. "*Politikat e privatësisë*" duhet të informojnë në lidhje me fushën dhe qëllimin për të cilin do të përpunohen të dhënat personale, kategoritë e të dhënave që përpunohen, të drejtat e subjekteve të të dhënave, si dhe detyrimet e kontrolluesit në kuadër të mbrojtjes së privatësisë. Mospublikimi i tyre privon subjektin e të dhënave në ushtrimin e të drejtave sipas ligjit.

### 3.2.3 Sanksione administrative

Për shkeljet e konstatuara Komisionerit ka dalë me 18 vendime, të cilat korrespondojnë me 37 sanksione administrative.




## 3.3 Njoftimi

Në përmbushje të detyrimit ligjor të kontrolluesve për të njoftuar për përpunimin e të dhënave personale, gjatë vitit 2020 në regjistrin përkatës u shtuan 65 subjekte të reja.

Gjithashtu, janë shqyrtuar dhe regjistruar deklaratat e 28 kontrolluesve për ndryshim të gjendjes së njoftimit të përpunimit të njoftuar më parë. Numri i përgjithshëm i njoftimeve të përpunimeve nga kontrolluesit në territorin e Republikës së Shqipërisë është 5742.

**REGJISTRI I NJOFTIMEVE**




### 3.4 Transferimi ndërkombëtar

Niveli i mbrojtjes së të dhënave personale për një shtet përcaktohet duke vlerësuar të gjitha rrethanat lidhur me përpunimin, natyrën, qëllimin dhe kohëzgjatjen e tij, shtetin e origjinës dhe destinacionin përfundimtar, aktet ligjore dhe standardet e sigurisë në fuqi në shtetin marrës. Në zbatim të parashikimeve ligjore, Komisioneri ka dalë me 1 Vendim për lejimin e transferimit ndërkombëtar në shtete pa nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale.

# 4. VEPRIMTARIA JURIDIKE, PROCEDURAT ADMINISTRATIVE DHE GJYQËSORE

## 4.1 Hartimi i akteve rregullatore

Në kuadër të procesit të integrimit të vendit në BE, si dhe detyrimeve që burojnë nga akte ndërkombëtare, gjatë vitit 2020, Zyra e Komisionerit është angazhuar intensivisht në përafrimin e legjislacionit në fuqi me *acquis communautaire*. Janë hartuar dhe miratuar akte ligjore dhe nënligjore, të cilat plotësojnë kuadrin rregullator në të dy fushat e veprimtarisë së institucionit.

### 4.1.1 Përafrimi i legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale me GDPR dhe Direktivën e Policisë

Rregullat e reja që përmban GDPR, konsistojnë në dhënien e një kontrolli më të madh qytetarëve për të dhënat e tyre personale, rritjen e përgjegjshmërisë së shoqërive tregtare dhe përforcimin e rolit të autoritetit mbikëqyrës. Gjithashtu, reforma përmban në paketën e saj të modernizimit edhe Direktivën për mbrojtjen e personave fizikë në lidhje me përpunimin e të dhënave personale nga autoritetet kompetente me qëllim parandalimin, hetimin, zbulimin, ndjekjen penale të veprave penale apo ekzekutimin e dënimeve penale dhe për lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave dhe shfuqizimin e Vendimit Kuadër të Këshillit 2008/977/JHA, e njohur si Direktiva e Policisë.

Zyra e Komisionerit është përfituese e Projektit të Binjakëzimit *"Mbështetje institucionit për përafrimin e legjislacionit mbi mbrojtjen e të dhënave personale me acquis-in e Bashkimit Evropian"*. Ai financohet nga Programi i BE IPA 2017, objektiv kryesor i të cilit është kuadri i ri legjislativ në këtë fushë, forcimi i kapaciteteve institucionale të Zyrës së Komisionerit dhe rritja e ndërgjegjësimit të kontrolluesve/përpunuesve për respektimin e të drejtave të qytetarëve.

Gjatë vitit 2020 u ndoqën të gjithë procedurat për përzgjedhjen e autoritetit homolog që asiston këtë proces. Fitues rezultoi konsorciumi i shteteve anëtare Itali–Austri, përfaqësuar për zbatimin e Projektit nga Autoriteti Italian për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (*Garante per la Protezione dei Dati Personali*), mbështetur nga Instituti për të Drejtat e Njeriut Ludwig Boltzmann Gesellschaft, Austri dhe CSI-Piemonte, Itali. Projekti filloi zbatimin e tij me datë 01.10.2020 dhe zgjat 12 muaj.

Përfundimi i zbatimit të Projektit të Binjakëzimit do të shënojë edhe miratimin e kuadrit të ri ligjor në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale të përafruar me *acquis* përkatese të BE në këtë fushë.

### 4.1.2 Miratimi në parim i protokollit ndryshues të Konventës 108 të KiE

Konventa për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale të Këshillit të Evropës, prej 40 vjetësh shërben si bazë legjislative rregullatore ndërkombëtare në këtë fushë. Mbi 50 shteteve në Evropë e më gjerë, e kanë adoptuar këtë instrument në kuadrin e tyre rregullator. Republika e Shqipërisë e ka ratifikuar Konventën 108, si dhe Protokollin shtesë të saj nr. 181, me anë të ligjeve nr. 9287/2004 dhe nr. 9288/2004.

Konventa 108 u miratua në 28 janar 1981, duke i paraprirë digjitalizimit, zhvillimit të internetit dhe tregtisë globale elektronike. Zhvillimi i teknologjisë, globalizimi i informacionit dhe qarkullimi gjithnjë e më i madh i të dhënave personale në mjedisin digjital, sjell sfida të reja në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale. Në optikën e këtyre zhvillimeve, por edhe për të qënë komplementare me GDPR, u finalizua modernizimi i Konventës 108 me Protokollit ETS nr. 223 në maj 2018, tashmë e emërtuar Konventa 108+.

Zyra e Komisionerit me qëllim përafrimin me standardet ndërkombëtare të fushës intensifikoi hapat në përgatitjen e projektligjit *"Për ratifikimin e protokollit ndryshues të Konventës 108 "Për mbrojtjen e individëve nga përpunimi automatik i të dhënave personale""*. Me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1001, datë 09.12.2020, u miratua në parim protokolli ndryshues i Konventës 108, për të vijuar gjatë këtij viti me procedurat e nënshkrimit dhe ratifikimin e saj. Me ndryshimet e pritshme të legjislacionit kombëtar, qytetarëve shqiptarë u garantohen standardet më të larta aktualisht sot në botë në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale.

### 4.1.3 Miratimi në parim i Konventës për aksesin në dokumentet zyrtare të KiE

Transparenca e autoriteteve publike është një tipar kyç i mirëqeverisjes. E drejta e aksesit në dokumentet zyrtare është rruga për pjesëmarrjen e qytetarëve në procesin e vendimmarrjes, çka forcon përgjegjshmërinë dhe integritetin e administratës publike. Konventa 205/2009 e KiE, është dokumenti i cili vendos standardet që duhen zbatuar në shqyrtimin e kërkesave për akses në dokumente zyrtare.

Zyra e Komisionerit duke u bazuar në nevojën për plotësimin dhe zhvillimin më tej të kuadrit ligjor në fuqi për të drejtën e informimit, hartoi projektligjin *"Mbi aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën nr. 205/2009, të Këshillit të Evropës, "Mbi aksesin në dokumentet zyrtare""*. Me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1123, datë 30.12.2020, u miratua në parim Konventa e KiE *"Për aksesin në dokumentet zyrtare",* për të vijuar më tej me procedurat deri në nënshkrimin dhe ratifikimin e saj.

### 4.1.4 Miratimi i projektligjit mbi të dhënat e hapura dhe ri-përdorimin e informacionit të sektorit publik

Përparimi i shpejtë teknologjik, përdorimi i Inteligjencës Artificiale (AI), Internetit të gjërave (IoT), komunikimet makinë-makinë, mundësojnë krijimin e shërbimeve dhe aplikacioneve të reja, të cilat bazohen në mbledhjen, përdorimin dhe kombinimin e të dhënave, duke krijuar ekonominë e të dhënave. Me qënë se sasia e të dhënave në botë, përfshirë edhe të dhënat publike, është rritur në mënyrë eksponenciale, zbatimi i konceptit "të dhënat e hapura - open data" është domosdoshmëri edhe në legjislacionin shqiptar, në përputhje me standardet e BE apo praktikat më të mira ndërkombëtare. Kjo qasje e re do të ndikojë ndjeshëm duke nxitur zhvillimin e sektorit TIK dhe ekonomisë kombëtare, në përgjithësi. Iniciativa plotëson kuadrin rregullator në fushën e të drejtës për informim ndërkohë që autoritetit i shtohet një kompetencë e re, që është mbrojtja, mbikëqyrja, garantimi dhe promovimi i së drejtës për ripërdorimin e informacionit publik.

Zyra e Komisionerit, inicioi hartimin e projektligjit *"Mbi të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik",* i cili përafron Direktivën e BE 2019/1024 "*Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik*". Akti u hartua në kuadër të pjesëmarrjes së institucionit në Grupin Ndërinstitucional të Punës për Integrimin Europian të Kapitullit 10 *"Shoqëria e Informacionit dhe Media",* në bashkëpunim me institucionin lider të këtij kapitulli, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë. Me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.796, datë 12.10.2020, u miratua propozimi i projektligjit *"Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik",* për të vijuar më tej me procedurat për miratimin e tij.

#### 4.1.5 Projektligji për krijimin e Regjistrit të komunikimeve tregtare të pakërkuara

Një nga fenomenet më shqetësuese të përdorimit të të dhënave personale në ekonominë digjitale janë thirrjet/komunikimet e pa kërkuara. Përvojat e ndryshme evropiane na tregojnë rrugët për mbikëqyrjen efektive të kësaj problematike, e cila gjatë viteve të fundit është bërë prezente edhe në Shqipëri. Një nga kategoritë kryesore të ankesave ka lidhje, pikërisht, me përdorimin e mjeteve të komunikimit masiv (telefon, email, etj.) nga ofrues të ndryshëm shërbimi me qëllim reklamues.

Zyra e Komisionerit inicioi punën për hartimin e projektligjit *"Për krijimin e regjistrit të komunikimeve tregtare të pa kërkuara"*, duke vlerësuar se ky është mekanizmi i duhur mbrojtës për qytetarët. Me krijimin e tij përcaktohen rregulla të qarta për aksesimin, administrimin dhe përpunimin e ligjshëm të të dhënave personale të qytetarëve. Për konsultimin e projektligjit edhe me aktorë të tjerë të rëndësishëm, u ngrit grupi i punës me përfaqësues të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare, si dhe Komisionit të Mbrojtjes së Konsumatorëve pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Në përfundim të këtij procesi, projektligji u depozitua në Kuvend në 3–mujorin e parë të vitit 2021.

### 4.2 Udhëzimet

Autoriteti ndërmori hapat e domosdoshëm për të plotësuar dhe përmirësuar kuadrin rregullator në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, në zbatim të detyrimeve ligjore në fuqi.

Në bashkëpunim me Ministrinë e Brendshme, si një detyrim që buron nga ligji për gjendjen civile, u miratua Udhëzimi nr. 463, datë 10.12.2020 "Për përcaktimin e institucioneve dhe organeve që marrin të dhëna personale nga shërbimi i gjendjes civile, si dhe mënyrën, llojin dhe sasinë e informacionit që duhet të marrin". Akti adreson zhvillimet në përdorimin e teknologjive të reja në ofrimin e shërbimeve shtetërore online. Në të njëjtën kohë, udhëzimi shton numrin e institucioneve të reja apo ristrukturuara, të cilat e kanë të domosdoshme aksesin në RKGJC për përmbushjen e detyrave funksionale.

Po në bashkëpunim me Ministrinë e Brendshme, si një detyrim që buron nga ligji për kontrollin kufitar, u miratua Udhëzimi nr. 464, datë 10.12.2020 "Për transmetimin e të dhënave të pasagjerit te Njësia e Informacionit të Pasagjerit". Ky akt përcakton Zyrën e Komisionerit si Autoritetin Kombëtar përgjegjës, si dhe standarde të unifikuara për

mbikëqyrjen e procesit të mbledhjes/përpunimit, shpërndarjes dhe shkëmbimit të të dhënave personale të pasagjerëve. Udhëzimi sanksionon mënyrën e transmetimit të të dhënave dhe sigurimin e nivelit të përshtatshëm të mbrojtjes së të dhënave personale nga Njësia e Informacionit të Pasagjerëve (NIP) në Policinë e Shtetit, në rast të një problemi teknik që pamundëson operimin e sistemit.

### 4.3 Dhënie mendimi për projektakte

Zyra e Komisionerit është angazhuar në dhënien e mendimeve për projektaktet ligjore e nënligjore në raport me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale. Krahasimisht me një vit më parë, vërehet një rritje e numrit të akteve për të cilët është kërkuar opinion. Institucioni ka dhënë mendim për 31 projektligje, projektvendime dhe projektmarrëveshje. Gjithashtu, janë përgatitur 120 opinione ligjore të paraqitura për mendim nga kontrollues publik e privat. Në Aneksin 3 të këtij Raporti do të gjeni një listë me aktet ligjore e nënligjore të miratuara gjatë vitit 2020, për të cilat Zyra e Komisionerit ka vlerësuar se duhej të shprehej paraprakisht lidhur me to.

**DHËNIE MENDIMI PËR PROJEKTAKTE 2017-2020**




| | Dhënie mendimi për p/ligje | Dhënie mendimi për p/vendime, p/marrëveshje, p/udhëzimeve etj |
|---|---|---|
| 2017 | 2 | 17 |
| 2018 | 4 | 22 |
| 2019 | 7 | 6 |
| 2020 | 7 | 24 |

Zyra e Komisionerit, për vitin 2020, ka ndjekur në total 35 procese gjyqësore pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Për periudhën raportuese, u ndoqën 30 procese gjyqësore me objekt ligjin për të drejtën e informimit, ndër të cilat: 6 çështje administrative janë ndjekur për vendime të dhëna në vitin 2020, 17 çështje janë ndjekur për akte administrative, 2 çështje administrative janë ndjekur për vendime të dhëna nga Komisioneri në vitin 2019 dhe 5 procese gjyqësore janë të mbartura. Nga 30 procese gjyqësore, gjykata ka vendosur për 6 çështje lënien në fuqi të vendimit të Komisionerit, 3 pranimin e kërkesë padisë, 7 pranim të pjesshëm të padisë, 10 pushimin e gjykimit për Zyrën e Komisionerit me kërkesë të palës paditëse me argumentin se institucioni ka përmbushur funksionin e tij administrativ, ndërsa 4 çështje vijojnë të jenë në proces.

## PROCESE GJYQËSORE PËR TË DREJTËN PËR INFORMIM

| VITI | 2020 |
|---|---|
| **Procese Gjyqësore** | **30** |
| **Rrëzim padie** | **6** |
| **Pranim padie** | **3** |
| **Pushim gjykimi për KDIMDP** | **10** |
| **Në proces** | **4** |
| **Pranim i pjesshëm i padisë** | **7** |

Komisioneri për vitin 2020, në përputhje me dispozitat e ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, ka dalë me 18 vendime. Ndër to, për 13 vendime kontrolluesit kanë ekzekutuar vullnetarisht sanksionet administrative, për 3 vendime autoriteti ka kërkuar ekzekutimin e detyrueshëm, ndërsa për 2 vendime pritet plotësimi i afatit. Nga ana tjetër, gjatë këtij viti pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë janë ndjekur 3 procese gjyqësore me objekt ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale, për të cilat gjykata ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Komisionerit.

Gjithashtu, institucioni ka shprehur qëndrimin e tij pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër mbi një çështje administrative me objekt ligjin për njoftimin dhe konsultimin publik, ku në përfundim të procesit gjyqësor, me vendimarrjen e saj gjykata ka konfirmuar qëndrimin e Komisionerit mbi trajtimin e këtij rasti. Pjesë e çështjeve gjyqësore të ndjekura gjatë këtij viti ka qënë edhe një proces me objekt mardhënie punë për të cilën gjykata ka vendosur rrëzimin e padisë dhe lënien në fuqi të vendimit të Komisionerit.

## PROCESE GJYQËSORE PËR TË MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

| VITI | 2020 |
|---|---|
| **Procese Gjyqësore** | **3** |
| **Rrëzimin e kërkesëpadisë** | **3** |
| **Pranim e kërkesëpadisë** | **0** |
| **Ekzekutime vullnetare** | **13** |
| **Ekzekutime të detyrueshëm** | **3** |
| **Në proces ekzekutimi të detyrueshëm** | **2** |

Gjatë vitit 2020, Zyra e Komisionerit ka ndjekur edhe procese gjyqësore në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë. Numri total i çështjeve të regjistruara pranë kësaj gjykate është 37, ndër të cilat, 34 vijojnë të jenë në proces, për 1 çështje gjykata ka vendosur rrëzimin e padisë dhe për 2 çështje vendosi prishjen e vendimit dhe kthimin për rigjykim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

# 5. BASHKËPUNIMI, NDËRGJEGJËSIMI DHE PROMOVIMI I TË DREJTËS PËR INFORMIM DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

## 5.1 Bashkëpunimi ndërkombëtar, ndërinstitucional dhe me shoqërinë civile

### 5.1.1 Bashkëpunimi ndërkombëtar

Në vijim të punës përmbyllëse pas organizimit nga Zyra e Komisionerit të Konferencës së 41-të Ndërkombëtare ICDPPC në tetor 2019 në Tiranë, u finalizua Raporti i aktivitetit. Dokumenti është hartuar në bashkëpunim me Sekretariatin e GPA dhe është miratuar nga Komiteti Ekzekutiv, organi më i lartë drejtues i organizatës.

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale u rizgjodh dhe për një mandat 1-vjeçar si anëtar me të drejta të plota i Komitetit Ekzekutiv të GPA. Po ashtu, Komisioneri u rikonfirmua edhe si anëtar i Nën-komitetit të Drejtimit Strategjik të GPA. Niveli i lartë i përfaqësimit është vlerësim për kontributin e institucionit dhe ndërveprimit me autoritetet homologe në kuadër të GPA.

Zyra e Komisionerit mori pjesë në punimet e Sesionit të Mbyllur virtual të GPA, të mbajtur më 13-15 tetor 2020. Në këtë aktivitet u trajtuan çështje të ndjeshme për mbrojtjen e privatësisë dhe të dhënave personale, si: përballimi i situatës së pandemisë globale COVID-19, përdorimi i teknologjive të reja, identifikimi i fytyrës apo inteligjenca artificiale, mbrojtja e të dhënave në veprimtarinë humanitare, etj. Sesioni i Mbyllur miratoi 5 rezoluta, ku në disa prej tyre Zyra e Komisionerit ka dhënë kontributin e saj në cilësinë e bashkë-propozuesit : ·

- Rezoluta mbi Teknologjinë e Njohjes së Fytyrës;
- Rezoluta mbi Rolin e Mbrojtjes së të Dhënave Personale në Ndihmën Ndërkombëtare për Zhvillim, Ndihma Ndërkombëtare Humanitare dhe Menaxhimi i Krizës;
- Rezoluta mbi Llogaridhënien në Zhvillimin dhe Përdorimin e Inteligjencës Artificiale;
- Rezoluta mbi Deklaratat e Përbashkëta për Çështjet Globale që po lindin;
- Rezoluta mbi Sfidat e Privatësisë dhe Mbrojtjes së të Dhënave që po Lindin në Kontekstin e Pandemisë COVID-19.

Zyra e Komisionerit, gjithashtu, u rikonfirmua si anëtare me të drejta të plota e Konferencës Ndërkombëtare të Komisionerëve të Informimit (ICIC), pas riorganizimit të këtij forumi gjatë vitit 2020.

### 5.1.2 Marrëdhënia me EUROJUST

Zyra e Komisionerit e ka përmbushur me prioritet monitorimin e zbatimit të marrëveshjes me EUROJUST.

Në kuadër të procesit të caktimit dhe konfirmimit të personave të kontaktit për mbrojtjen e të dhënave personale, institucioni ka qenë në kontakt të përhershëm me Prokurorinë e

Përgjithshme dhe prokuroritë në rrethe. Ndërsa, monitorimi në terren mbi realizimin e detyrimeve për mbrojtjen e të dhënave personale nga sistemi i prokurorisë, për shkak të periudhës së pandemisë ka qenë i pamundur.

Autoriteti me qëllim forcimin e kapaciteteve dhe trajnimit të stafit, në funksion të procesit të monitorimit sipas standardeve të kësaj marrëveshje, është në kontakt me partnerë ndërkombëtare. Është kërkuar asistencë teknike nga projekti i ri IPA 2019 *"Lufta kundër krimeve të rënda në Ballkanin Perëndimor"*, që zbatohet nga GIZ, i cili është vijim i Projektit të mëparshëm që asistoi në finalizimin e hyrjes së fuqi të Marrëveshjes me Eurojust. Po ashtu, mbështetje në këtë drejtim është kërkuar edhe nga Ambasada e Mbretërisë së Vendeve të Ulëta.

### 5.1.3 Bashkëpunimi me shoqërinë civile

Në kuadër të bashkëpunimit me organizatat e shoqërisë civile gjatë vitit 2020 u realizuan disa aktivitete me fokus forcimin e të drejtës për informim:

- takime me përfaqësues të organizatave *"Together for Life", "Birn Albania"*, *"Faktoje.al", "Qendresa Qytetare", "Institutin për Demokraci dhe Ndërmjetësim"*, ku u diskutuan problematika në lidhje me transparencën dhe kontributin e shoqerisë civile në këtë drejtim;
- bashkëpunim me shoqatën *"Lëviz Albania"* për të zhvilluar webinar-in me përfaqësuesit e shoqërisë civile me temë *"Programi i Transparencës: element ndërlidhës mes Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe aktorëve të shoqërisë civile për forcimin e demokracisë vendore";*
- bashkëpunim me "*Institutin për Demokraci dhe Ndërmjetësim"* për t'u prezantuar përfaqësuesve të shoqërisë civile raportin e monitorimit *"Vlerësimi i Transparencës dhe Llogaridhënies në Bashkitë Elbasan, Lezhë, Durrës, Kukës, Fier, Gjirokastër, Tiranë dhe Shkodër"*;
- institucioni u bë pjesë e fokus grupit në kuadër të projektit *"Forcimi i bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të sigurisë, mekanizmave monitories dhe shoqërisë civile"*, organizuar nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim.

Gjithashtu, stafi i Zyrës së Komisionerit ka qënë pjesë e webinar-eve/trajnimeve të ndryshme të zhvilluara nga organizata ndërkombëtare dhe të shoqërisë civile:

- webinar i OSBE *"Monitorimi, Analizimi, Përdorimi dhe Ripërdorimi i të Dhënave për të Forcuar Transparencën e Qeverisë dhe Proceset e Vendimmarrjes;*
- webinar i UNDP Albania, për prezantimin e Raportit të Vlerësimit të Qeverisjes Vendore në Shqipëri, ku ndër komponentët e vlerësuar ishte dhe *"Transparenca e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore";*
- webinar i Zyrës së UNESCO me temë "*Zbatueshëmëria e qasjes në informacion dhe zgjidhja e krizave përgjatë përhapjes së COVID-19"*;
- webinar i shoqatës Qendresa Qytetare me temë *"Analiza financiare dhe e performancës të Rezistencës Studentore Universitare Nr.1 Tiranë në raportin tarifë-shërbim të drejtat studentore";*

- trajnim i shoqatës Together for Life me përfaqësuesit e institucioneve të pavarura *"Media dhe procesi i integrimit të Shqiperisë në Bashkimin Evropian";*
- konferencë e shoqatës Together for Life me temë *"Roli i Mekanizmit Parlamentar në Fuqizimin e Institucioneve të Pavarura".*

Edhe këtë vit, Zyra e Komisionerit ka një bashkëpunim të frutshëm dhe konsulton rekomandimet e organizatave të shoqërisë civile, duke i reflektuar ato në veprimtarinë e saj.

## 5.2 Trajnime të Zyrës së Komisionerit

Situata e krijuar nga pandemia globale e bëri të vështirë organizimin e trajnimeve për ndërgjegjësimin për zbatimin e legjislacionit në të dy fushat e veprimtarisë së autoritetit.

Në muajin qershor, u zhvilluan trajnime online me koordinatorë të institucioneve qendrore, të pavarura dhe njësive të vetëqeverisjes vendore mbi zbatimin e ligjit për të drejtën e informimit në kushtet e pandemisë. Fokusi i takimeve ishte rëndësia e përditësimit të Programit të Transparencës dhe Regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve, instrumente të rëndësishme për rritjen e transparencës dhe llogaridhënies së autoriteteve publike.

Një tjetër trajnim online u mbajt këtë muaj me koordinatorët e bashkive, me temë "*Regjistri elektronik i kërkesave dhe përgjigjeve për të drejtën e informimit*". Qëllimi i tij ishte ndërgjegjësimi për të instaluar REKPDI në sa më shumë institucione të vetëqeverisjes vendore.

Në bashkëpunim me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike u zhvillua trajnimi me temë "*Mbrojtja e te dhënave personale*". Në të morën pjesë nëpunës civilë të TND nga institucione të ndryshme. Fokusi i trajnimit ishte njohja me kuadrin ligjor kombëtar dhe atë ndërkombëtar, veçanërisht GDPR.

Trajnimi *"E drejta e informimit, transparencë për mirëqeverisjen"* me pjesëmarrjen e koordinatoreve të kryeministrisë dhe ministrive u mbajt në muajin tetor. Gjatë tij u diskutuan çështje rreth transparencës proaktive, zbatimin e rekomandimeve për përditësimin e Programit të Transparencës, përdorimin e REKPDI nëpërmjet portalit *pyetshtetin.al*, si dhe problematikat e hasura gjatë trajtimit të ankesave.

## 5.3 Aktivitete të tjera ndërgjegjësuese

Për rritjen e ndërgjegjësimit për respektimin e të drejtave të qytetarëve janë zhvilluar aktivitete për të dy fushat e veprimtarisë së institucionit.

Në 28 janar 2020, në Ditën e Mbrojtjes së të Dhënave Personale, në bashkëpunim me Shkollën e Mesme Profesionale TIK *"Hermann Gmeiner",* u organizua konkursi *"Të rinjtë dhe privatësia".* Aktiviteti me këtë rast u mbajt në Qendrën e Inovacionit Protik. 10 grupe nxënësish të viteve të 3-ta dhe 4-ta të kësaj shkolle prezantuan projekt-aplikacione, ku "*politikat e privatësisë*" ishin elementi kryesor i vlerësimit.

Për përgatitjen e punimeve mësimore stafi i Zyrës së Komisionerit dhe ai i shkollës realizuan një cikël trajnues gjatë muajit janar 2020, për njohjen me parimet kryesore

rregullatore në garantimin e privatësisë dhe mbrojtjen e të dhënave personale. Aplikacioni "*StudentGuard*" u shpall fitues. Ky projekt është një sistem monitorimi mbi frekuentimin e mësimit, për të vënë në dijeni prindin. Aplikacionet e tjera të prezantuara në konkurs përfshijnë fusha, si ajo e menaxhimit të financave personale apo të biznesit; menaxhimin e të dhënave shëndetësore apo respektimin e dietave ushqimore; lundrimin e sigurt në internet; blerjeve online; kontrollin e postës elektronike, etj.

Që prej muajit korrik ka nisur publikimi në faqen zyrtare në internet të newsletter-it elektronik *"E drejta për informim"*. Ky format është një përmbledhje e veprimtarisë mujore të institucionit mbi mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit për të drejtën e informimit

Zyra e Komisionerit u angazhua në publikimin e posterit *"Transparenca në distancë",* i cili kishte si qëllim ndërgjegjësimin e autoriteteve publike për të qenë sa më proaktiv edhe në kushtet e pandemisë.

Në 28 shtator 2020, në Ditën e të Drejtës për Informim, u zhvillua video-projeksion në sheshin *"Nënë Tereza"*. Aktiviteti u mbajt në kuadër të iniciativave ndërgjegjësuese për qytetarët për ushtrimin aktiv të të drejtës për t'u njohur me informacionin me karakter publik, nëpërmjet zbatimit të ligjit për të drejtën e informimit.

Zyra e Komisionerit, në bashkëpunim dhe koordinim me Drejtorinë e Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar (DPAP), në muajin mars 2020 do të niste Fushatës Kombëtare *"Edukimi digjital, luaj dhe mëso–Happy Onlife"*. Por ky projekt u riprogramua për shkak të situatës që shkaktoi pandemia, duke zhvilluar fazën e parë të tij në periudhën tetor-dhjetor 2020, ku u mbajtën 22 takime në shkolla 9-vjeçare në 21 qytete të vendit. Në bashkëbisedim me pjesëmarrësit – nxënës e mësues, u ndanë informacione dhe këshilla praktike për mbrojtjen e privatësisë dhe të dhënave personale, sidomos në përdorimin e rrjeteve sociale. Loja *"Happy Onlife"*, ku bazohet projekti, ka si qëllim që të nxisë të rinjtë që nga i menduari kritik të mësojnë për përdorimin e sigurt të të dhënave personale në mjedisin digjital. Kjo lojë është ideuar dhe përgatitur nga Qendra Kërkimore Evropiane (JRC). Projekti parashikohet të përmbushet në 6-mujorin e parë të vitit 2021.

Zyra e Komisionerit riprogramoi edhe zhvillimin e aktiviteteve të parashikuara me universitetet, të cilat u mbajtën online në muajt nëntor dhe dhjetor. Në këto trajnime morën pjesë studentë e staf akademik/administrativ të Universiteteve të Vlorës *"Ismail Qemali"* dhe Universitetit të Durrësit *"Aleksandër Moisiu"*. Për të rritur ndërgjegjësimin dhe njohjen me të drejtat e qytetarëve, u diskutua mbi legjislacionin për të drejtën e informimit dhe atë të mbrojtjes së të dhënave personale, për rolin dhe funksionet e institucionit, si dhe u trajtuan raste praktike.

# 6. MENAXHIMI BUXHETOR

## 6.1 Struktura organizative

Veprimtaria e shtuar e Zyrës së Komisionerit për garantimin e dy të drejtave të qytetarëve, përmbushja e detyrave e funksioneve të përcaktuara në ligje të tjera, por, sidomos, kuadri i ri rregullator për mbrojtjen e të dhënave personale motivoi paraqitjen për miratim pranë institucioneve përgjegjëse dhe Kuvendit në maj të vitit 2020, të një strukturë më të plotë të autoritetit.

Me ligjin nr. 137 datë 16.11.2020 *"Për buxhetin e vitit 2021"*, Zyrës së Komisionerit iu miratua numri i përgjithshëm prej 44 punonjësish, krahasuar me 37 në vitin 2019. Në përputhje me këtë ligj, me Vendimin e Kuvendit nr. 84/2020 *"Për disa shtesa e ndryshime të Vendimit nr. 86/2018 "Për miratimin e strukturës, organikës dhe klasifikimit të pagave të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale""*, u miratua struktura dhe organigrama e ndryshuar, e cila ka hyrë në fuqi me 1 janar 2021. Me këto përmirësime, institucioni ka riformatuar mënyrën e organizimit strukturor të njësive dhe emërtesat e tyre, nivelet dhe kategoritë e pagës, pozicionet e punës dhe shpërndarjen e numrit të punonjësve në çdo strukturë, me qëllim administrimin më efikas të burimeve njerëzore në raport me veprimtarinë e institucionit.

## 6.2 Zhvillimi i burimeve njerëzore

Aftësimi profesional i nëpunësve për përmbushjen në kohë dhe me cilësi të detyrave të ngarkuara është element thelbësor për një institucion efikas.

Situata e krijuar nga pandemia COVID-19, orientoi Zyrën e Komisionerit të përshtasë infrastrukturën e rrjetit të brendshëm për krijimin e kushteteve të përshtatshme për organizimin e takimeve dhe trajnimeve nëpërmjet platformave të ndryshme online. Në zbatim të Planit Vjetor të Trajnimeve nga trajnimet e organizuara nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike u certifikuan 15 nëpunës në 10 tematika të ndryshme.

Në kuadër të zhvillimit të burimeve njerëzore, vlen të theksohet bashkëpunimi me Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë për thirrjen e 5-të të Programit Kombëtar të Praktikave të Punës, për zhvillimin e praktikës 3-mujore të studentëve me qëllim aftësimin dhe zhvillimin e kompetencave të tyre profesionale dhe njohjen me sistemin e administratës publike.

## 6.3 Të ardhurat dhe shpenzimet

Me ligjin nr. 88/2019 *"Për buxhetin e shtetit të vitit 2020",* fondet e akorduara, me ndryshimet gjatë vitit, për funksionimin e aktivitetit institucional në total u miratuan në vlerën 66.826 (*në mijë lekë*). Për përballimin e situatës së pandemisë u ndërmorën masa shtesë, duke rishikuar me prioritet dhe orientuar shpenzimet buxhetore drejt aktiviteteve kryesore të institucionit, në respektim të parimeve dhe rregullave të menaxhimit financiar. Fondet e vitit 2020 u reduktuan në masën 3.000 (*në mijë lekë*), duke pakësuar zërin e *"shpenzimeve operative"* dhe kalimin e fondeve në buxhetin e shtetit për emergjencën shëndetësore.

Nga fondi i përgjithshëm buxhetor i planifikuar për vitin 2020, me ndryshimet gjatë vitit, u shpenzuan 65.965 (*në mijë lekë*). Buxheti në tërësinë e tij u realizua në masën 98.7%, kundrejt planit vjetor 2020. Tabela pasqyron realizimin në vlerë dhe në përqindje çdo kategori shpenzimesh përkundrejt totalit të buxhetit të akorduar.

**REALIZIMI I BUXHETIT 2020**

**000/lekë** **000/lekë**

| Nr. | EMËRTIMI | PLAN | PËRQINDJE KUNDREJT TOTALIT | FAKT 12 MUJOR | PËRQINDJE REALIZIMI KUNDREJT PLANIT VJETOR |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Paga | 43.926 | 66% | 43.758 | 99.6% |
| 2 | Sigurime shoqërore | 7.250 | 11% | 7.171 | 98.9% |
| 3 | Mallra e shërbime të tjera | 14.110 | 21% | 13.691 | 97% |
| 4 | Investime | 1.000 | 1.4% | 999 | 99.9% |
| 5 | Transferta dhe fondi i veçantë | 440 | 0.5% | 270 | 61% |
| 6 | Kuotizacion | 100 | 0.1% | 76 | 76% |
| | **Totali** | **66.826** | **100%** | **65.965** | **98.7%** |

Pjesën kryesore të shpenzimeve e zënë pagat e personelit, si dhe kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore. Fondi i përgjithshëm i pagave është realizuar për numrin faktik të punonjësve, në vlerën 43.758 (*në mijë lekë*) ose 99.6% dhe për kontributet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore në vlerën 7.171 (*në mijë lekë*) ose 98.9% e planifikimit. Shpenzimet e tjera korrente dhe investimet, të planifikuara dhe të miratuara me financim të brendshëm, janë realizuar në vlerën 15.036 (*në mijë lekë*) ose 96% e planifikimit. Mosrealizimet kanë ardhur si rezultat i ofertave më të ulta nga procedurat e prokurimeve dhe nga përdorimi në masën 15%, të fondit të veçantë.

### 6.4 Të ardhurat nga sanksionet

Për vitin 2020 u arkëtuan në total të ardhura nga sanksionet administrative për shkelje të dispozitave të legjislacionit në fuqi në masën 2.629 (*në mijë lekë*), sanksione të cilat u arkëtuan në masën 100% në buxhetin e shtetit. Sanksionet e vendosura janë në shumën 1.860 (*në mijë lekë*), nga ku vlera e arkëtuar ishte 1.590 (*në mijë lekë*) ose 85% e totalit. Nga ana tjetër, është arkëtuar edhe shuma 1.039 (*në mijë lekë*) për sanksione administrative që i përkasin periudhave të mëparshme.

Ekzekutimi i sanksioneve kryhet vullnetarisht ose nëpërmjet shërbimit përmbarimor. Për vitin 2020, vërehet se 86% e vlerës së arkëtuar është shlyer vullnetarisht nga kundërvajtësit, tregues ky i ndërgjegjësimit për zbatimin në mënyrë të menjëhershme të vendimeve të Komisionerit.

## 7. RAPORT PROGRESI I KOMISIONIT EVROPIAN PËR SHQIPËRINË MBI ZYRËN E KOMISIONERIT

Zyra e Komisionerit ka adresuar plotësisht rekomandimet e lëna nga Raport Progresi i Komisionit Evropian (KE) për vitin 2019. Gjithashtu, me publikimin në datë 6 tetor të Raport Progresit të Komisionit Europian për vitin 2020, institucioni në koordinim me Ministrinë e Drejtësisë në cilësinë e institucionit lider të Kapitullit "Kriteri Politik" dhe Kapitullit 23 ka përgatitur planin e masave mbi zbatimin dhe monitorimin e përmbushjes së rekomandimeve që KE ka evidentuar për institucionin.

1. *Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale duhet të ketë kompetenca më të mëdha mbikëqyrjeje. Ekziston një regjistër qendror për kërkesat për informacion, por mbulimi i tij duhet të zgjerohet*

Lidhur me pjesën e parë të rekomandimit, vlen të theksohet se zbatimi i tij është përtej kapacitetit dhe kompetencave të Zyrës së Komisionerit. Përmes ndryshimeve ligjore të parashikuara në ligjin për të drejtën e informimit dhe ligjin e ri për mbrojtjen e të dhënave personale do të adresohet çështja e zgjerimit të kompetencave mbikëqyrëse.

Në lidhje me pjesën e dytë të rekomandimit, gjatë vitit 2020 vijoi ndërgjegjësimi i autoriteteve publike për funksionalizimin e REKPDI. Në mungesë të fondeve për instalimin në mënyrë të centralizuar të këtij regjistri, Zyra e Komisionerit u kërkoi autoriteteve të pavarura dhe njësive të vetëqeverisjes vendore ta bëjnë këtë me fondet e tyre buxhetore. 28 autoritete të reja e instaluan regjistrin, duke e çuar në 59 numrin total të institucioneve të cilat e kanë funksional atë, përkundrejt 31 që kjo shifër ishte në fund të vitit 2019.

2. *Lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale, nevojiten përpjekje të mëtejshme për të harmonizuar legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale me Rregulloren e Përgjithshme të Mbrojtjes së të Dhënave 2016/679 dhe Direktivën e Policisë 2016/680.*

Për zbatimin e këtij rekomandimi janë marrë masat për përmbushjen e tij të plotë brenda vitit 2021. Një informacion më të detajuar mbi këto masa, jepet në pikën *4.1.1* të këtij Raporti.

3. *Shqipëria nuk ka nënshkruar ende Protokollin 2018, i cili ndryshon Konventën për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale.*

Zyra e Komisionerit e ka adresuar plotësisht këtë rekomandim. Një informacion më i detajuar mbi masat e marra në këtë kuadër, jepet në pikën *4.1.2* të këtij Raporti.

4. *Kapaciteti i Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale duhet të forcohet më tej në mënyrë që ajo të kryejë detyrat e saj në mënyrë efektive.*

Ky rekomandim është adresuar plotësisht pas miratimit të Vendimit nr. 84/2020 të Kuvendit.

5. *Aksesi në informacion në lidhje me kontratat e prokurimit, kontrollet dhe pagat e zyrtarëve gjithashtu duhet të forcohet. Vendimet e Komisionerit për të Drejtën e Informimit nuk janë detyruese për zyrtarët e administratës publike.*

   Në lidhje me pjesën e parë të këtij rekomandimi qasja në informacionin me karakter publik bëhet në mënyrë proaktive dhe aktive. Mënyra e parë i referohet publikimit të informacionit/dokumentacionit në Programin e Transparencës, ndërsa e dyta ushtrohet me kërkesë. Në të dyja rastet është autoriteti publik i cili i mban këto kategori informacioni, që duhet t'i bëjë publike në faqen zyrtare ose t'ja vërë në dispozicion kërkuesit.

   Përsa i përket pjesës së dytë, rekomandimi adresohet në projektaktin e hartuar për ndryshimin e ligjit për të drejtën e informimit, duke e kthyer vendimin e Komisionerit në titull ekzekutiv. Projektakti për ndryshimet në ligjin për të drejtën e informimit, ku parashikohen dhe kompetencat e Komisionerit në këtë fushë, është rekomanduar nga projekti të propozohet njëkohësisht me ligjin e ri për mbrojtjen e të dhënave personale.

# 8. PËRMBUSHJA E DETYRIMEVE NDËRKOMBËTARE DHE RAPORTIME

Zyra e Komisionerit është pjesë e Kapitullit “*Kriteri Politik*”, Kapitullit 10 *“Shoqëria e Informacionit dhe Media*” dhe Kapitullit 23 *“Gjyqësori dhe të drejtat themelore”* të procesit të integrimit evropian. Si pjesë e këtyre kapitujve, gjatë këtij viti janë përgatitur Analiza e mangësive ligjore dhe përditësimi i Tabelës së kapaciteteve institucionale dhe administrative në kuadër të procesit të *screening*.

Si pjesë e detyrimeve që burojnë nga bashkëpunimi ndërkombëtar është dhënë kontributi në hartimin e:

- katër raporteve në zbatim të Vendimit të Kuvendit nr. 134/2018, ndër të cilat, një raport në funksion të zbatimit të Rezolutës dhe tre raporte për zbatimin e rekomandimeve të Komisionerit nga institucionet përkatëse;
- raportit për Ministrinë e Evropës dhe Punët e Jashtme mbi veprimtarinë e Zyrës së Komisionerit për vitin 2019 dhe 3-mujorin e parë të vitit 2020, në kuadër të takimit të 12-të të Nënkomitetit Bashkimi Evropian-Shqipëri “Drejtësia, Liria dhe Siguria”;
- raportit mbi veprimtarinë e institucionit në kuadër të hartimit dhe dërgimit të kontributit të tretë dhe të katërt të qeverisë shqiptare për Raportin e Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2020, për Kapitullin “Kriteri Politik”, Kapitullin 23 dhe Kapitullin 10;
- raportit në kuadër të hartimit të Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2021-2023, për Kapitullin “Kriteri Politik”, Kapitullin 23 dhe Kapitullin 10, mbi planifikimin e akteve ligjore dhe dokumenteve strategjike që synojnë përafrimin me legjislacionin e BE;
- planit të masave të autoritetit për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga Raport Progresi i Komisionit Evropian për vitin 2020;
- raportimin për rekomandimet e GRECO mbi raundin të pestë të vlerësimit;
- raportit periodik në kuadër të pjesëmarrjes në Grupin e Berlinit.

## 9. NIVELI I ZBATIMIT TË REZOLUTËS SË KUVENDIT 2020

Me Rezolutën e miratuar në datë 21.05.2020, Kuvendi kërkoi nga Zyra e Komisionerit përmbushjen e rekomandimeve:

1. *Të përmirësojë programin model të transparencës dhe modelit të regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve për autoritetet publike.*
2. *Të forcojë rolin e personit të kontaktit për garantimin e sigurisë së përpunimit të të dhënave.*
3. *Të monitorojë dhënien e mbështetjes për autoritetet publike, si dhe të marrë masa për krijimin dhe vënien në eficensë brenda vitit 2020 të regjistrit elektronik të kërkesave dhe përgjigjeve për të drejtën e informimit.*
4. *Të mbikëqyrë kontrolluesit me fokus platformat online, sektorin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit ose sektorë që përpunojnë të dhëna sensitive dhe të paraqesë një raport të veçantë pranë Kuvendit të Shqipërisë, që ka të bëjë me pasqyrimin e gjendjes për mbrojtjen e të dhënave personale.*
5. *Të vijojë me dhënien e kontributit në përafrimin e legjislacionit të mbrojtjes së të dhënave personale në përputhje me legjislacionin përkatës të BE, konkretisht me Rregulloren e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave Personale 2016/2019 (GDPR) dhe Direktivën e Policisë 2016/680.*
6. *Të luaj rol aktiv në procesin e diskutimit dhe miratimit të projektligjit për ratifikimin e Protokollit që ndryshon Konventën e Këshillit të Evropës "Për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale".*
7. *Të asistojë në dhënien e kontributit për hartimin e projektligjit "Mbi të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik", në kuadër të transpozimit të Direktivës 2019/1024 BE, me qëllim plotësimin e kuadrit ligjor për të drejtën e informimit.*
8. *Të asistojë në hartimin e kuadrit të nevojshëm ligjor për mbrojtjen e konsumatorëve/subjekteve të të dhënave personale nga thirrjet e pa kërkuara ose dërgimit të mesazheve me postë elektronike.*
9. *Të vijojë me monitorimin e zbatimit të detyrimeve lidhur me marrëveshjen e bashkëpunimit me Eurojust dhe në bashkëpunim me Oficerin e Mbrojtjes së të Dhënave Personale në Eurojust të hartojë raportin vjetor për Komisionin Europian.*
10. *Të vijojë aktivitetet ndërgjegjësuese dhe trajnuese të Komisionerit në kuadër të fushave të veprimtarisë për informimin dhe ndërgjegjësimin për të drejtat dhe detyrimet.*

Zyra e Komisionerit ka realizuar plotësisht këto 10 rekomandime për vitin 2020. Duke qënë se autoriteti i mbështet objektivat institucionalë vjetor, referuar, ndër të tjera, edhe këtyre rekomandimeve, në këtë Raport identifikohen të gjitha hapat e marra për përmbushjen e tyre. Një informacion i detajuar është dërguar në mënyrë elektronike pranë Kuvendit.

## 10. VIZIONI I INSTITUCIONIT

Viti 2020, si një periudhë e karakterizuar nga adresimi i problematikave të panjohura e të menjëhershme që imponoi pandemia globale COVID-19, e ridimensionoi të gjithë veprimtarinë e Zyrës së Komisionerit. Por, themelet e forta për hopin cilësor në punën e institucionit janë hedhur dhe kjo nënkupton, nisjen e një faze të re, më dinamike, në garantimin e standardeve moderne të të drejtave dhe lirive themelore të qytetarëve shqiptarë. Veçanërisht, kontributi i institucionit për modernizimin e kuadrit rregullator, si pjesë e procesit të integrimit në BE, është sinjifikativ dhe i vlerësuar brenda dhe jashtë vendit. Ky kontribut do të vijojë edhe gjatë vitit 2021, ku objektivat kryesore do të jenë:

- ✓ *Miratimi i legjislacionit të ri në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, i përafruar me GDPR dhe Direktivën e Policisë, nëpërmjet zbatimit me sukses të Projektit të Binjakëzimit "Mbështetje institucionit për përafrimin e legjislacionit mbi mbrojtjen e të dhënave personale me acquis-in e Bashkimit Evropian";*
- ✓ *Ndërtimi i kapaciteteve për zbatimin e kuadrit të ri rregullator për mbrojtjen e të dhënave personale, si dhe rritjen e përgjegjshmërisë së grupeve të interesit në mënyrë që të sigurohet respektimi i të drejtave të qytetarëve;*
- ✓ *Rol aktiv në përmbylljen e procesit të ratifikimit të Konventës 108+ dhe Konventës 205 të KiE;*
- ✓ *Rol aktiv në miratimin e projektligjit "Për krijimin e regjistrit të komunikimeve tregtare të pa kërkuara";*
- ✓ *Miratimin e ndryshimeve në ligjin për të drejtën e informimit;*
- ✓ *Rol aktiv në miratimin e projektligjit "Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik";*
- ✓ *Monitorimi sistematik i kategorive specifike të autoriteteve publike për publikimin/përditësimin e Programit të Transparencës dhe Regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve, për të rritur llogaridhënien dhe mirëqeverisjen e tyre në raport me interesat e qytetarëve;*
- ✓ *Nxitja e autoriteteve publike të maksimizojnë cilësinë e dhënies së informacionit me karakter publik, me më pak kohë dhe kosto, duke zgjeruar përdorimin e funksioneve të portalit pyetshtetit.al, si dhe duke forcuar rolin e koordinatorit në strukturat e tyre të brendshme;*
- ✓ *Monitorimi dhe mbikëqyrja e zbatimit të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale, me fokus, ndër të tjera, verifikimin e respektimit të parimeve dhe kritereve të përpunimit dhe masave tekniko-organizative në lidhje me garantimin e sigurisë dhe konfidencialitetin e të dhënave;*
- ✓ *Krijimi i një kulture gjithëpërfshirëse për mbrojtjen e privatësisë dhe të dhënave personale në mjedisin digjital, me fokus brezin e ri, si një nga realitetet ku Zyra e Komisionerit do të ballafaqohet më shpesh në vitet në vijim.*

Standardet bashkëkohore për respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut nuk mund të kuptohen pa një institucion me nëpunës të trajnuar, motivuar dhe aktiv. Mbikëqyrja e plotë ligjore kërkon dhe orienton njohuri nga fusha të ndryshme, rrjedhimisht, vendosjen e urave të reja të bashkëpunimit si në sferën publike ashtu edhe në atë private të shoqërisë. Në këtë mënyrë, nga shkëmbimi i eksperiencës do të rritet eficienca në veprimtarinë e institucionit, për një performancë më dinamike dhe zgjidhje praktike të problemeve të qytetarëve.

## ANEKS 1 - STRUKTURA DHE ORGANIGRAMA



| **Funksioni** | **Nr. i punonjësve** | **Kategoria/Klasa** |
| --- | --- | --- |
| **Gjithsej 44 punonjës** | | |
| I. Komisioneri | 1 | I-D Ligji nr. 9584, datë 17.7.2006, i ndryshuar |
| II Kabineti | 3 | VKM. 187 datë 8.3.2017 |
| Drejtor | 1 | II - a |
| Këshilltar | 1 | II - b |
| Zëdhënës | 1 | II - b |
| III. Drejtoria e Përgjithshme për të Drejtën e Informimit **(10)** | | |
| Drejtor i Përgjithshëm | 1 | II-a |
| III/I. Drejtoria e Monitorimit të Programeve të Transparencës | | |
| Drejtor | 1 | II-b |
| Inspektorë | 3 | III-a |
| III/II. Drejtoria e Vlerësimit të Ankesave | | |
| Drejtor | 1 | II-b |
| Inspektorë | 4 | III-a |
| IV. Drejtoria Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave Personale **(12)** | | |
| Drejtor i Përgjithshëm | 1 | II-a |

| | | |
|---|---|---|
| IV/I. Drejtoria e Ankesave dhe Harmonizimit | | |
| Drejtor | 1 | II - b |
| Inspektorë | 4 | III - a |
| IV/II. Drejtoria e Hetimit Sektorial dhe Sigurisë së të dhënave | | |
| Drejtor | 1 | II - b |
| Inspektorë | 5 | III-a |
| V. Drejtoria e Çështjeve Juridike dhe Integrimit **(7)** | | |
| Drejtor | 1 | II-b |
| V/I. Sektori Rregullator, Integrimit dhe Procedurave Administrative | | |
| Shef sektori | 1 | III-a |
| Inspektorë | 2 | III-a |
| V/II. Sektori i Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë | | |
| Shef sektori | 1 | III-a |
| Specialistë | 2 | III-b |
| VI. Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme dhe Financës **( 11 )** | | |
| Drejtor | 1 | II-b |
| VI/I. Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Mardh. me Publikun | | |
| Shef sektori | 1 | III-a |
| Specialist IT | 1 | III-b |

| | | |
|---|---|---|
| Specialist i burimeve njerëzore/analist i punës | 1 | III-b |
| Specialist i marrëdh. me publikun | 1 | III-b |
| Nëpunës informacioni | 1 | KI. III (VKM nr.717, datë 23.02.2009, i ndryshuar) |
| VI/II. Sektori i Shërbimeve dhe Financës | | |
| Shef sektori (pers. Përgj. Prokurimet) | 1 | III-a |
| Specialist financë – buxhet/shërbime | 1 | III-b |
| Specialist redaktor/protokoll/arkiv | 1 | IV-a |
| Magazinier/shofer | 1 | KI. VI (VKM nr 717, datë 23.06.2009 i ndryshuar) |
| Punonjës Pastrimi | 1 | KI. VI (VKM nr 717, datë 23.06.2009 i ndryshuar) |

## ANEKS 2 - REKOMANDIMET E ZYRËS SË KOMISIONERIT PËR VITIN 2020 PËR KONTROLLUESIT PUBLIK DHE NIVELI I ZBATIMIT TË TYRE

| REKOMANDIMI | KONTROLLUESI PUBLIK | AFATI PËR ZBATIM | STATUSI I ZBATIMIT (Përmbushur nga këto institucione) |
|---|---|---|---|
| **Nr. 1, datë 17.01.2020,** *"Për caktimin e personit të kontaktit"* *(Mbi respektimin e detyrimeve ligjore në kuadër të mbrojtjes së të dhënave personale nga organet e administratës shtetërore)*<br><br>**Problematika që adresohet**:<br><br>*Të merren masa të menjëhershme nga ana e organeve të administratës shtetërore, për caktimin e një Personi Kontakti për mbrojtjen e të dhënave personale dhe përditësimin e të dhënave të tij në rast se ky person ka ndryshuar;*<br>*Ministritë e linjës të marrin masa për caktimin e personave të kontaktit edhe në organet e varësisë.* | Kryeministria;<br>Ministria e Mbrojtjes;<br>Ministria e Brendshme;<br>Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme;<br>Ministria e Drejtësisë;<br>Ministria e Financës dhe Ekonomisë;<br>Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë;<br>Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë;<br>Ministria e Kulturës;<br>Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural<br>Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;<br>Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit;<br>Ministrisë së Shtetit për Diasporën;<br>Ministrisë së Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes;<br>Ministri i Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin;<br>Ministri i Shtetit për Rindërtim;<br>Avokatura e Shtetit; | Nuk është lënë afat. | Kryeministria;<br>Ministria e Drejtësisë;<br>Ministria e Mbrojtjes;<br>Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme;<br>Ministria e Kulturës;<br>Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;<br>Ministria e Shtetit për Rindërtim;<br>Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;<br>Ministria për Diasporën;<br>Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë;<br>Ministria e Shtetit për Marrëdhëniet më Parlamentin;<br>Prefekti i Qarkut Durrës;<br>Prefekti i Qarkut Korçë;<br>Prefekti i Qarkut Elbasan;<br>Prefekti i Qarkut Kukës;<br>Prefekti i Qarkut Berat;<br>Prefekti i Qarkut Fier;<br>Prefekti i Qarkut Gjirokastër;<br>Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit;<br>Departamenti i Administratës Publike (DAP); |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit ;<br>Departamenti i Administratës Publike;<br>Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar;<br>Prefekti i Qarkut Tiranë;<br>Prefekti i Qarkut Durrës;<br>Prefekti i Qarkut Elbasan;<br>Prefekti i Qarkut Shkodër;<br>Prefekti i Qarkut Lezhë;<br>Prefekti i Qarkut Kukës;<br>Prefekti i Qarkut Dibër;<br>Prefekti i Qarkut Korçë;<br>Prefekti i Qarkut Gjirokastër;<br>Prefekti i Qarkut Vlorë;<br>Prefekti i Qarkut Fier;<br>Prefekti i Qarkut Berat; | | Prefekti i Qarkut Tiranë. |
| **Nr. 2, datë 11.05.2020**, *"Për publikimin e "Politikave të Privatësisë*", *në faqet zyrtare nga institucionet e administratës shtetërore". (Mbi respektimin e detyrimeve ligjore në kuadër të mbrojtjes së të dhënave personale nga organet e administratës shtetërore).*<br><br>**Problematika që adresohet**: | Kryeministria;<br>Ministria e Mbrojtjes;<br>Ministria e Brendshme;<br>Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme;<br>Ministria e Drejtësisë;<br>Ministria e Financës dhe Ekonomisë;<br>Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë;<br>Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë;<br>Ministria e Kulturës; | Nuk është lënë afat | Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;<br>Prefekti i Qarkut Berat;<br>Prefekti i Qarkut Dibër;<br>Prefekti i Qarkut Fier;<br>Prefekti i Qarkut Gjirokastër;<br>Departamenti i Administratës Publike;<br>Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë;<br>Prefekti i Qarkut Tiranë; |

| | | | |
|---|---|---|---|
| *Në faqet onlinetë institucioneve, të publikohen në një rubrikë të veçantë "politikat e privatësisë", ku të përfshihet informimi i subjekteve të të dhënave si dhe kushtet e kriteret që reflektojnë parimet e përpunimit të ligjshëm dhe të drejtë të të dhënave personale. Gjithashtu, edhe pas publikimit të tregohet kujdes, në ndryshimin apo modifikimin e kësaj rubrike në zbatim të çdo ndryshimi të mundshëm të legjislacionit në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale apo legjislacionin specifik.*<br>*Të plotësohet detyrimi për njoftim nga kontrolluesit të cilët nuk e kanë zbatuar këtë detyrim për herë të parë si dhe të tregohet kujdes në vijimësi, në përditësimin e njoftimit për ndryshimin e gjendjes së njoftimit të përpunimit, të njoftuar më parë.* | Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;<br>Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;<br>Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit;<br>Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit ;<br>Departamenti i Administratës Publike;<br>Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar;<br>Prefekti i Qarkut Tiranë;<br>Prefekti i Qarkut Durrës;<br>Prefekti i Qarkut Elbasan;<br>Prefekti i Qarkut Shkodër;<br>Prefekti i Qarkut Lezhë;<br>Prefekti i Qarkut Kukës;<br>Prefekti i Qarkut Dibër;<br>Prefekti i Qarkut Korçë;<br>Prefekti i Qarkut Gjirokastër;<br>Prefekti i Qarkut Vlorë;<br>Prefekti i Qarkut Fier;<br>Prefekti i Qarkut Berat. | | |

| | | | |
|---|---|---|---|
| **Nr. 4, datë 05.06.2020** *"Për programin e transparencës së autoritetit publik "Prefekti i Qarkut Tiranë".*<br><br>***Problematika që adresohet:***<br>*Autoriteti Publik/Prefekti i Qarkut Tiranë, në zbatim të germave a), b) dhe c) të pikës 2 të nenit 4 dhe nenit 5 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", të rishikojë/përditësojë programin e transparencës.*<br>*Autoriteti Publik duhet të pasqyrojë, në programin e transparencës, të gjitha kategoritë e informacionit të detyrueshëm për tu bërë publike në përputhje me nenin 7, të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit".* | Prefekti i Qarkut Tiranë | 90 ditë nga marrja dijeni | Përmbushur pjesërisht |

| | | | |
|---|---|---|---|
| **Nr. 5, datë 05.06.2020** *“Për programin e transparencës së autoritetit publik “Prefekti i Qarkut Durrës”.*<br>***Problematika që adresohet:***<br>*Autoriteti Publik/Prefekti i Qarkut Durrës, në zbatim të germave a), b) dhe c) të pikës 2 të nenit 4 dhe nenit 5 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, të rishikojë/përditësojë programin e transparencës.*<br>*Autoriteti Publik duhet të pasqyrojë, në programin e transparencës, të gjitha kategoritë e informacionit të detyrueshëm për tu bërë publike në përputhje me nenin 7, të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”.* | Prefekti i Qarkut Durrës | 90 ditë nga marrja dijeni | Përmbushur pjesërisht |
| **Nr. 6, datë 05.06.2020** *“Për programin e transparencës së autoritetit publik “Prefekti i Qarkut Vlorë”.*<br>***Problematika që adresohet:***<br>*Autoriteti Publik/Prefekti i Qarkut Vlorë, në zbatim të germave a), b) dhe c) të pikës 2 të nenit 4 dhe nenit 5 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, të* | Prefekti i Qarkut Vlorë | 90 ditë nga marrja dijeni | Përmbushur pjesërisht |

| | | | |
|---|---|---|---|
| *rishikojë/përditësojë programin e transparencës.*<br>*Autoriteti Publik duhet të pasqyrojë, në programin e transparencës, të gjitha kategoritë e informacionit të detyrueshëm për tu bërë publike në përputhje me nenin 7, të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit".* | | | |
| **Nr. 7, datë 05.06.2020** *"Për programin e transparencës së autoritetit publik "Prefekti i Qarkut Kukës".*<br>***Problematika që adresohet:***<br>*Autoriteti Publik/Prefekti i Qarkut Kukës, në zbatim të germave a), b) dhe c) të pikës 2 të nenit 4 dhe nenit 5 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", të rishikojë/përditësojë programin e transparencës.*<br>*Autoriteti Publik duhet të pasqyrojë, në programin e transparencës, të gjitha kategoritë e informacionit të detyrueshëm për tu bërë publike në përputhje me nenin 7, të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit".* | Prefekti i Qarkut Kukës | 90 ditë nga marrja dijeni | Përmbushur pjesërisht |

| | | | |
|---|---|---|---|
| **Nr. 16, datë 22.07.2020** *"Për programin e transparencës së autoritetit publik "Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve".*<br><br>***Problematika që adresohet:***<br><br>*Autoriteti Publik/Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve, në zbatim të germave a), b) dhe c) të pikës 2 të nenit 4 dhe nenit 5 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", të rishikojë/përditësojë programin e transparencës.*<br>*Autoriteti Publik duhet të pasqyrojë, në programin e transparencës, të gjitha kategoritë e informacionit të detyrueshëm për tu bërë publike në përputhje me nenin 7, të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit".* | Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve | 90 ditë nga marrja dijeni | Përmbushur pjesërisht |

| | | | |
|---|---|---|---|
| **Nr. 22, datë 16.10.2020** *"Për programin e transparencës së autoritetit publik, Bashkia Pukë".*<br><br>***Problematika që adresohet:***<br><br>*Autoriteti Publik/Bashkia Pukë duhet të pasqyrojë, në programin e transparencës, të gjitha kategoritë e informacionit të detyrueshëm për tu bërë publike në përputhje me nenin 7, të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit" dhe me Urdhërin nr. 211, datë 10.09.2018 "Për miratimin e Programit Model të Transparencës për Njësitë e Qeverisjes Vendore", të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale".* | Bashkia Pukë | 90 ditë nga marrja dijeni | Në proces |
| **Nr. 24, datë 22.10.2020** *"Për programin e transparencës së autoritetit publik, Bashkia Kamëz"*<br><br>***Problematika që adresohet:***<br><br>*Autoriteti Publik/Bashkia Kamëz duhet të pasqyrojë, në programin e transparencës, të gjitha kategoritë* | Bashkia Kamëz | 90 ditë nga marrja dijeni | Në proces |

| | | | |
|---|---|---|---|
| *e informacionit të detyrueshëm për tu bërë publike në përputhje me nenin 7, të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit" dhe me Urdhërin nr. 211, datë 10.09.2018 "Për miratimin e Programit Model të Transparencës për Njësitë e Qeverisjes Vendore", të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale".* | | | |
| ***Nr. 28, datë 23.12.2020,** "Për programin e transparencës së autoritetit publik, Bashkia Mirditë"*<br><br>***Problematika që adresohet:***<br><br>*Autoriteti Publik/Bashkia Mirditë duhet të pasqyrojë/ndërlidh në programin e transparencës, të gjitha kategoritë e informacionit të detyrueshëm për tu bërë publike në përputhje me nenin 7, të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit" dhe me Urdhrin nr. 211, datë 10.09.2018 "Për miratimin e Programit Model të Transparencës për Njësitë e Qeverisjes Vendore", të* | Bashkia Mirditë | 90 ditë nga marrja dijeni | Në proces |

| | | | |
|---|---|---|---|
| *Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale".* | | | |
| **Nr. 29, datë 23.12.2020** *"Për programin e transparencës së autoritetit publik, Bashkia Mallakastër"*<br><br>***Problematika që adresohet:*** *Autoriteti Publik/Bashkia Mallakastër duhet të pasqyrojë/ndërlidh në programin e transparencës, të gjitha kategoritë e informacionit të detyrueshëm për tu bërë publike në përputhje me nenin 7, të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit" dhe me Urdhrin nr. 211, datë 10.09.2018 "Për miratimin e Programit Model të Transparencës për Njësitë e Qeverisjes Vendore", të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale".* | Bashkia Mallakastër | 90 ditë nga marrja dijeni | Në proces |
| **Nr. 30, datë 23.12.2020** *"Për programin e transparencës së autoritetit publik, Bashkia Roskovec"*<br><br>***Problematika që adresohet:*** | Bashkia Roskovec | 90 ditë nga marrja dijeni | Në proces |

| | | | |
|---|---|---|---|
| *Autoriteti Publik/Bashkia Roskovec duhet të pasqyrojë/ndërlidh në programin e transparencës, të gjitha kategoritë e informacionit të detyrueshëm për tu bërë publike në përputhje me nenin 7, të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit" dhe me Urdhrin nr. 211, datë 10.09.2018 "Për miratimin e Programit Model të Transparencës për Njësitë e Qeverisjes Vendore", të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale".* | | | |
| **Nr. 31, datë 23.12.2020** *"Për programin e transparencës së autoritetit publik, Bashkia Kukës"*<br><br>***Problematika që adresohet:***<br><br>*Autoriteti Publik/Bashkia Kukës duhet të pasqyrojë/ndërlidh në programin e transparencës, të gjitha kategoritë e informacionit të detyrueshëm për tu bërë publike në përputhje me nenin 7, të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit" dhe me Urdhrin nr. 211, datë 10.09.2018 "Për miratimin e Programit Model të* | Bashkia Kukës | 90 ditë nga marrja dijeni | Në proces |

| | | | |
|---|---|---|---|
| *Transparencës për Njësitë e Qeverisjes Vendore", të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale".* | | | |
| **Nr. 32, datë 23.12.2020** *"Për programin e transparencës së autoritetit publik, Bashkia Peqin"*<br><br>***Problematika që adresohet:***<br><br>*Autoriteti Publik/Bashkia Peqin duhet të pasqyrojë/ndërlidh në programin e transparencës, të gjitha kategoritë e informacionit të detyrueshëm për tu bërë publike në përputhje me nenin 7, të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit" dhe me Urdhrin nr. 211, datë 10.09.2018 "Për miratimin e Programit Model të Transparencës për Njësitë e Qeverisjes Vendore", të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale".* | Bashkia Peqin | 90 ditë nga marrja dijeni | Në proces |
| **Nr. 33, datë 23.12.2020** *"Për programin e transparencës së autoritetit publik, Bashkia Devoll"* | Bashkia Devoll | 90 ditë nga marrja dijeni | Në proces |

| | | | |
|---|---|---|---|
| ***Problematika që adresohet:***<br><br>*Autoriteti Publik/Bashkia Devoll duhet të pasqyrojë/ndërlidh në programin e transparencës, të gjitha kategoritë e informacionit të detyrueshëm për tu bërë publike në përputhje me nenin 7, të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit" dhe me Urdhrin nr. 211, datë 10.09.2018 "Për miratimin e Programit Model të Transparencës për Njësitë e Qeverisjes Vendore", të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale".* | | | |
| **Nr. 34, datë 23.12.2020** *"Për programin e transparencës së autoritetit publik, Bashkia Dropull"*<br><br>***Problematika që adresohet:***<br><br>*Autoriteti Publik/Bashkia Dropull duhet të pasqyrojë/ndërlidh në programin e transparencës, të gjitha kategoritë e informacionit të detyrueshëm për tu bërë publike në përputhje me nenin 7, të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e* | Bashkia Dropull | 90 ditë nga marrja dijeni | Në proces |

| | | | |
|---|---|---|---|
| *informimit" dhe me Urdhrin nr. 211, datë 10.09.2018 "Për miratimin e Programit Model të Transparencës për Njësitë e Qeverisjes Vendore", të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale".* | | | |
| **Nr. 35, datë 23.12.2020** *"Për programin e transparencës së autoritetit publik, Bashkia Librazhd"*<br>***Problematika që adresohet:***<br>*Autoriteti Publik/Bashkia Librazhd duhet të pasqyrojë/ndërlidh në programin e transparencës, të gjitha kategoritë e informacionit të detyrueshëm për tu bërë publike në përputhje me nenin 7, të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit" dhe me Urdhrin nr. 211, datë 10.09.2018 "Për miratimin e Programit Model të Transparencës për Njësitë e Qeverisjes Vendore", të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale".* | Bashkia Librazhd | 90 ditë nga marrja dijeni | Në proces |

| | | | |
|---|---|---|---|
| **Nr. 36, datë 23.12.2020** *"Për programin e transparencës së autoritetit publik, Bashkia Elbasan"* ***Problematika që adresohet:*** <br><br> *Autoriteti Publik/Bashkia Elbasan duhet të pasqyrojë/ndërlidh në programin e transparencës, të gjitha kategoritë e informacionit të detyrueshëm për tu bërë publike në përputhje me nenin 7, të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit" dhe me Urdhrin nr. 211, datë 10.09.2018 "Për miratimin e Programit Model të Transparencës për Njësitë e Qeverisjes Vendore", të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale".* | Bashkia Elbasan | 90 ditë nga marrja dijeni | Në proces |
| **Nr. 37, datë 23.12.2020** *"Për programin e transparencës së autoritetit publik, Bashkia Maliq"* <br><br> ***Problematika që adresohet:*** <br><br> *Autoriteti Publik/Bashkia Maliq duhet të pasqyrojë/ndërlidh në programin e transparencës, të gjitha kategoritë e informacionit të detyrueshëm për tu bërë publike në* | Bashkia Maliq | 90 ditë nga marrja dijeni | Në proces |

| | | | |
|---|---|---|---|
| *përputhje me nenin 7, të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit" dhe me Urdhrin nr. 211, datë 10.09.2018 "Për miratimin e Programit Model të Transparencës për Njësitë e Qeverisjes Vendore", të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale".* | | | |
| **Nr. 38, datë 23.12.2020** *"Për programin e transparencës së autoritetit publik, Bashkia Kolonjë"*<br><br>***Problematika që adresohet:***<br><br>*Autoriteti Publik/Bashkia Kolonjë duhet të pasqyrojë/ndërlidh në programin e transparencës, të gjitha kategoritë e informacionit të detyrueshëm për tu bërë publike në përputhje me nenin 7, të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit" dhe me Urdhrin nr. 211, datë 10.09.2018 "Për miratimin e Programit Model të Transparencës për Njësitë e Qeverisjes Vendore", të Komisionerit për të Drejtën e* | Bashkia Kolonjë | 90 ditë nga marrja dijeni | Në proces |

| | | | |
|---|---|---|---|
| *Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.* | | | |
| **Nr. 39, datë 23.12.2020** *“Për programin e transparencës së autoritetit publik, Bashkia Fier”*<br><br>***Problematika që adresohet:***<br><br>*Autoriteti Publik/Bashkia Fier duhet të pasqyrojë/ndërlidh në programin e transparencës, të gjitha kategoritë e informacionit të detyrueshëm për tu bërë publike në përputhje me nenin 7, të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit” dhe me Urdhrin nr. 211, datë 10.09.2018 “Për miratimin e Programit Model të Transparencës për Njësitë e Qeverisjes Vendore”, të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.* | Bashkia Fier | 90 ditë nga marrja dijeni | Në proces |
| **Nr. 40, datë 23.12.2020** *“Për programin e transparencës së autoritetit publik, Bashkia Cërrik”*<br><br>***Problematika që adresohet:***<br><br>*Autoriteti Publik/Bashkia Cërrik duhet të pasqyrojë/ndërlidh në* | Bashkia Cërrik | 90 ditë nga marrja dijeni | Në proces |

| | | | |
|---|---|---|---|
| *programin e transparencës, të gjitha kategoritë e informacionit të detyrueshëm për tu bërë publike në përputhje me nenin 7, të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit" dhe me Urdhrin nr. 211, datë 10.09.2018 "Për miratimin e Programit Model të Transparencës për Njësitë e Qeverisjes Vendore", të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale".* | | | |
| **Nr. 41, datë 23.12.2020** *"Për programin e transparencës së autoritetit publik, Bashkia Belsh"*<br><br>***Problematika që adresohet:***<br><br>*Autoriteti Publik/Bashkia Belsh duhet të pasqyrojë/ndërlidh në programin e transparencës, të gjitha kategoritë e informacionit të detyrueshëm për tu bërë publike në përputhje me nenin 7, të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit" dhe me Urdhrin nr. 211, datë 10.09.2018 "Për miratimin e Programit Model të Transparencës për Njësitë e Qeverisjes Vendore", të* | Bashkia Belsh | 90 ditë nga marrja dijeni | Në proces |

| | | | |
|---|---|---|---|
| *Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale".* | | | |
| **Nr. 42, datë 23.12.2020** *"Për programin e transparencës së autoritetit publik, Bashkia Berat"*<br><br>***Problematika që adresohet:***<br><br>*Autoriteti Publik/Bashkia Berat duhet të pasqyrojë/ndërlidh në programin e transparencës, të gjitha kategoritë e informacionit të detyrueshëm për tu bërë publike në përputhje me nenin 7, të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit" dhe me Urdhrin nr. 211, datë 10.09.2018 "Për miratimin e Programit Model të Transparencës për Njësitë e Qeverisjes Vendore", të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale".* | Bashkia Berat | 90 ditë nga marrja dijeni | Në proces |

## ANEKS 3 - MONITORIMI I FLETOREVE ZYRTARE

Ky aneks hartohet në referencë të Kapitullit 4 "*Veprimtaria ligjore, procedurat administrative dhe gjyqësore*" të Raportit Vjetor, bazuar në monitorimin që i është bërë Fletoreve Zyrtare për aktet ligjore dhe nënligjore të miratuara gjatë vitit 2020, të cilat nisur nga objekti dhe qëllimi, vlerësohet se duhet të kishin marrë më parë mendimin e Zyrës së Komisionerit.

**Ligje të cilat nuk janë paraqitur për mendim:**

1. ligji nr. 87, datë 29.03.2018 *"Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Austrisë për mbrojtjen shoqërore" (fz nr.03/2020*);
2. ligji nr. 46 datë 23.04.2020 *"Për ratifikimin e protokollit shtesë 6, mbi tregtinë e shërbimeve të marrëveshjes për amendimin dhe aderimin në marrëveshjen e tregtisë së lirë të Europës Qendrore" (fz. nr.82/2020);*
3. ligji nr. 81, datë 25.06.2020 *"Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve" (fz, nr.137/2020).*

**Vendime të Këshillit të Ministrave të cilat nuk janë paraqitur për mendim:**

1. VKM nr. 232, datë 20.12.2019 *"Mbi miratimin e "Rregullores dhe të metodologjisë për llogaritjen dhe vendosjen e dëmit ekonomik të shkaktuar nga ndërhyrjet e paligjshme në sistemin e matjes së energjisë elektrike" (fz nr.191/2020);*
2. VKM nr. 330 datë 22.4.2020 *"Për krijimin e bazës të të dhënave shtetërore "sistemi i deklarimit të pasurisë dhe konfliktit të interesit –EACIDS" (fz, nr.*77/2020);
3. VKM nr. 415, datë 27.5.2020 *"Për miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Turqisë, për njohjen e ndërsjellë dhe shkëmbimin e lejeve të drejtimit" (fz, nr. 99/2020);*
4. VKM nr. 431, datë 3.6.2020 *"Për platformën qendrore të faturave" (fz, nr.110/2020);*
5. VKM nr. 479, datë 17.6.2020, *"Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 108, datë 15.2.2017, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullores për mbrojtjen e fëmijëve në punë" (fz. nr.117/2020);*
6. VKM nr. 502, datë 24.6.2020 *"Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore "Regjistri elektronik i ekspertëve" (fz, nr.121/2020);*
7. VKM nr. 503, datë 24.6.2020 *"Për mënyrën e administrimit të informacionit elektronik shëndetësor" (fz, nr.121/2020);*
8. VKM nr. 504, datë 24.6.2020 *"Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të studentëve, të cilët studiojnë jashtë vendit, dhe shtetasve të huaj me origjinë shqiptare, të cilët përfitojnë bursa nga Republika e Shqipërisë" (fz, nr.121/2020);*
9. VKM nr. 971, datë 2.12.2020 *"Për miratimin e rregullave për politikat e përgjithshme shtetërore, për sistemin e teknologjisë së informacionit, për sistemin e drejtësisë", (fz, 213/2020)*

10. Vendimi i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, nr. 96, datë 15.4.2020 *"Për krijimin dhe administrimin pranë këshillit të lartë të prokurorisë të dosjes personale dhe të regjistrit të prokurorëve"*, *(fz, nr.70/2020);*

**Udhëzime të cilat nuk janë paraqitur për mendim:**

1. Udhëzimi nr. 20, i ministrit të Financave dhe Ekonomisë, datë 01.06.2020 *"Për elementet bazë dhe teknike, lëshimin dhe shkëmbimin e faturave elektronike dhe faturave shoqëruese" (fz, nr.103/2020);*
2. Udhëzim i përbashkët i ministrit të Drejtësisë dhe i Këshillit të Lartë Gjyqësor, nr. 09 datë 17.6.2020 *"Për përcaktimin e rregullave për krijimin e një baze të dhënash të posaçme për çështjet e dhunës në familje në gjykata dhe unifikimin e regjistrimit të tyre" (fz, nr.140/2020).*